

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6037
E hënë, 15 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Tusk, Hotit: Dialogu me Serbinë duhet të rifillohet me energji të re IFAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERAND STAVILECI IFAQE 4-5

PDK-ja, MODEL OPOZITARIZMI KUNDËR QEVERIVE TË MASHTRIMIT KURTI - HOTI



Drejtori ekzekutiv i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, ka bërë me dije se opozitarizmi i kësaj partie do të jetë model i një politikëbërjeje të re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se aktiviteti i PDK-së gjatë këtij mandati do të jetë në dy drejtime. Stavileci ka treguar se kjo parti do të prezantojë skema të mirëfillta ekonomike dhe sociale të rimëkëmbjes në dobi të qytetarëve dhe do t'i shkojë deri në fund demaskimit të politikave populiste. Sipas tij, edhe ish-kryeministri Kurti dhe kryeministri Hoti kanë marrë besimin qytetar duke e mashtruar me retorika e simbolika boshe

INTERVISTË ME DREJTORIN E SHKOLLAVE "MEHMET AKIF", NAZMI ULUS

EDHE PSE KOHË PANDEMIE, KA INTERESIM TË JASHTËZAKONSHËM PËR SHKOLLAT 'MEHMET AKIF' DHE 'ISP' IFAQE 7



MINISTRI ZEMAJ PARALAJMËRON TESTIME MASIVE, S'KA RIKTHIM TË MASAVE IFAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

RIFATI, HAMZA DHE ADEMI

F. 11

Bedri
ISLAMI



AKTUALE



BRENDA DISA DITËSH FSK-ja FILLON KAMPANJËN E REKRUTIMIT F. 6

RRIKET NUMRI I TË PREKURVE ME COVID-19 NË SHQIPËRI F. 2

KURTI KËRKON MBËSHTETJEN E MËRGATËS PËR PETICIONIN "DUAM ZGJEDHJE" F. 6

EKONOMI

BIZNESET NUK MORËN PARATË E PREMTUARA GJATË PANDEMISË F. 9

A MUND T'I MARRIN KONTRIBUTPAGESIT PARATË E TRUSTIT PENSIONAL? F. 9

SPORT

DRITA RIMERR POZITËN E PARË, GJILANI SHËNON FITORE BINDËSE F. 18

Rritet numri i të prekurve me Covid-19 në Shqipëri

TIRANË, 14 QERSHOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Shqipëri janë kryer 270 teste nga të cilat kanë rezultuar pozitive me Covid-19, 48 raste, kryesisht kontakte të rasteve të mëparshme, por edhe raste të reja që po hetohen.

Flutura Beqo nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka bërë me dije se shpërndarja e rasteve të reja është 24 raste në Tiranë, 8 në Krujë, 4 në Durrës, 3 në Fier, 2 Lezhë, 2 Pukë, 3 Kamëz, 1 Gjirokastrë, 1 Elbasan. "Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 5 qytetarë dhe aktualisht më shumë se 70 për qind e të prekurve që nga fillimi i epidemisë janë shëruar", ka thënë Beqo.

Ajo ka shtuar se në vend vazhdon të ketë shtrime të reja në Spitalin Infektiv.

Aktualisht në spitalin infektiv po marrin shërbim 52 pacientë, prej tyre 7 janë në terapi intensive dhe një i intubuar. "Në vendin tonë janë aktualisht 389 persona aktivë me Covid-19, kryesisht në Tiranë, Shkodër, Krujë", ka deklaruar Beqo.

Ajo ka theksuar se ditët e fundit është vënë re rritje e numrit të rasteve në disa aktivitete biznesi, në institucione të ndryshme, në pjesëmarrje në ceremoni mortore dhe grumbullime.

"Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apelon qytetarët, bizneset, që në mënyrë strikte të respektojnë zbatimin e masave të rekomanduara: distancën fizike, përdorimin e maskave në shërbim dhe kur nuk është e mundur të respektohet distanca, higjienën personale, dezinfektimin e ambienteve,



ajrosjen e tyre, në mënyrë që të kufizohet përhapja e Covid-19", është shprehur Beqo.

Ajo ka shtuar se inspektorët e Task-Forcës anti-Covid-19 do të vijnë në kontroll në çdo subjekt,

në institucione apo biznese tregtare të çdo lloji, për zbatimin e protokolleve të sigurisë. "Do të vijojë bashkëpunimi me forcat e rendit për kontrollin e vazhdueshëm për zbatimin e

karantinës të qytetarëve të konfirmuar pozitivë që janë pa shenja dhe që duhet të respektojnë detyrimin për të qëndruar të izoluar", ka bërë me dije Beqo.

Shkelja e rregullave, sipas saj, nga kushdo do të konsiderohet rrezik për jetën dhe shëndetin e të tjerëve.

Shqipëria gjatë javës së fundit është duke shënuar numra rekord të të prekurve me koronavirus. Në vend janë hequr të gjitha masat e detyrueshme të mbylljes së bizneseve, karantinimit e izolimit të njerëzve. Sipas qeverisë, tani është përgjegjësi e vet qytetarëve që të kujdesen dhe t'i zbatojnë rekomandimet për distancim. Virusi ka lënë të vdekur 35 persona prej kur është shfaqur për herë të parë në Shqipëri në muajin mars.

Meta: Dhurimi i gjakut për fëmijët talasemikë, mision fisnik dhe jetik



TIRANË, 14 QERSHOR - Me rastin e Ditës Botërore të Dhuruesve të Gjakut, në kuadër të nismës së ndërmarrë prej tij si dhe në bashkëpunim me "Aleancën për Dhurimin e Gjakut", presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka marrë pjesë në seancën e radhës të dhurimit të gjakut për fëmijët talasemikë, të mbajtur në selinë e Vëllazërisë Ungjillore Shqiptare.

Në takim të zhvilluar në Qendrën e Krishterë Shqiptare, ku merrte pjesë edhe Arqipeshkvi metropolit Tiranë-

Durrës, Imzot George Frendo, presidenti i Meta shprehu mirënjohjen kryepastorit Ylli Doçi dhe anëtarëve të Vëllazërisë Ungjillore si dhe të rinjve e të rejave vullnetarë për gatishmërinë e tyre për t'iu bashkuar kësaj kauze fisnike dhe humane.

Meta ka falënderuar Vëllazërinë Ungjillore dhe dhuruesit e gjakut, duke theksuar se dhënia e gjakut për fëmijët talasemikë, sidomos në këtë periudhë të vështirë të pandemisë së Covid-19, është një gjest tepër njerëzor

dhe mision jashtëzakonisht jetik. "Mirënjohje Bashkësisë Ungjillore Shqiptare, që prej 10 ditësh nëpërmjet një maratonte të dhurimit të gjakut, ka udhëtuar nga jugu në veri të Shqipërisë, nga Shkodra në Sarandë, nga Korça në Gjirokastrë, për t'u përfunduar sot më 14 qershor, në Ditën Botërore të Dhuruesve të Gjakut, në Tiranë, duke dhënë një kontribut të çmuar për këtë kauzë jashtëzakonisht humane dhe fisnike, për të cilën e gjithë shoqëria jonë i është mirënjohëse", ka deklaruar Meta.

Vdesin edhe nëntë persona në Maqedoninë e Veriut si pasojë e Covid-19

SHKUP, 14 QERSHOR - Maqedonia e Veriut vazhdon të përballet me shifra të larta të Covid-19 teksa të dielën u regjistruan 162 raste të reja dhe nëntë viktima. Tashmë totali i të infektuarve në

Maqedoninë e Veriut është 4 057, kurse deri më tani kanë vdekur 188 persona. Po ashtu, 1 710 persona janë shëruar, ndërsa 2 159 janë ende të infektuar aktivë me Covid-19.



Haradinaj takohet me kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhin

DURRËS, 14 QERSHOR - Ish-kryeministri dhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, është takuar të dielën në Shqipëri me kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhin. "Përsëri në Shqipëri, përsëri në Durrës. Kënaqësi të kem një bashkëbisedim me Monika Kryemadhin, kryetaren e LSI-së, lidhur me aktualitetin politik në dy shtetet tona. U gëzova, po ashtu, t'i shoh qytetarët e Kosovës që po i kthehen bregdetit shqiptar", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Ministri Zemaj paralajmëron testime masive, s'ka rikthim të masave

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë të dielën se nuk do të ketë rikthim të masave rigoroze, duke paralajmëruar se në ditët në vazhdim do të bëhen testime masive për Covid-19. Ai ka thënë se qytetarët duhet të mbajnë distancë, ta mbajnë pastërtinë dhe të përdorin maska. Ndërkaq Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, pas rritjes së rasteve me Covid-19, i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë që të mbyllën institucionet ku ka raste pozitive me këtë virus



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Për nder të 14 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Dhurimit Vullnetar të Gjakut, në Prishtinë janë vendosur tendat e Transfuzionit të Gjakut për të dhuruar gjak në mënyrë vullnetare. Me këtë rast, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka dhuruar gjak në njërin nga tendat e Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut. Aty Zemaj ka dhënë një mesazh për qytetarët sa i përket dhurimit të gjakut. "Dhuroni gjak, shpëtoni jetë, për të mirën e qytetarëve", ka thënë ai.

Zemaj ka folur edhe për rastet e personave të infektuar me Covid-19 në ndërmarrjet publike, për të cilat ka thënë se janë duke i analizuar këto raste, por ka shtuar se nuk do ta

lejojnë përhapjen e virusit në KEK siç ka ndodhur në Telekom. "Në Korporatën Energjetike të Kosovës, siç ka ndodhur në Telekom, nuk do të lejojmë rikthim të virusit. KEK-u ka qindra sektorë dhe nuk do të lejojmë përhapje të virusit. Ka ndodhur në Telekom, mirëpo nuk do të lejojmë të ndodhë edhe në KEK", ka thënë ministri Zemaj.

Ai ka folur edhe për lirimin e masave, për të cilat ka thënë se nuk do të ketë rikthim të masave rigoroze, duke paralajmëruar se në ditët në vazhdim do të bëhen testime masive. "Masat janë të hapura dhe lirimi i tyre konsiston në moskujdesin e përgjithshëm dhe kjo është diçka e pritshme. Rikthim nuk do të ketë. Dashtë Zoti të jemi të përgatitur për ndonjë valë shumë shpejt dhe do të kalojmë në testime masive", u shpreh Zemaj. Ai ka

treguar se këto raste janë të kontaktit prej datës 28 si dhe nga tubimi që ka ndodhur. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë ka njoftuar për 53 raste të reja me Covid-19 të shtunën, ndërsa shtatë persona janë shëruar. Ky rezultat vjen pas testimit të 313 mostrave, thuhet në njoftimin e IKShPK-së.

Nga data 8 shkurt deri më 13 qershor janë testuar gjithsej 18 247 persona të dyshimtë me Covid-19 dhe prej tyre pozitivë

kanë dalë gjithsej 1 437 raste, me gjithsej 33 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese.

Ndërkaq, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, pas rritjes së rasteve me Covid-19, i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë që të mbyllën institucionet ku ka raste pozitive me këtë virus. "Duke pasur parasysh se në javën e fundit kemi rritje të rasteve pozitive, që krahasohen me mesin e muajit prill dhe

kemi raste te punëtorët e organizatave publike, private, posta e Kosovës, KEK, KEDS, Galeri e Arteve, institucione bankare, shëndetësore, agjenci, kompani tregtare dhe biznese private, rekomandojmë Ministrinë e Shëndetësisë të mbyllën sektorët ku ka raste pozitive dhe të gjitha rastet pozitive dhe kontaktet e tyre të mbahen në vetizolim dhe bartja e maskave është obliguese", është bërë me dije në njoftimin e IKShPK-së.

Tusk, Hotit: Dialogu me Serbinë duhet të rifillohet me energji të re

**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pranuar letër urimi nga presidenti i Partive Popullore Evropiane, Donald Tusk. Ky i fundit e ka uruar Hotin për marrjen e detyrës ndërsa, mes të tjerash, në letër thuhet se dialogu me Beogradin duhet të rifillohet me energji të re. "Me kënaqësi të madhe ju uroj se jeni bërë kryeministër i Kosovës në fillim të këtij muaji. Emërimi juaj vjen në një kohë kur Kosova po përballet me sfida të mëdha: pandemia Covid-19, pasojat e saj ekonomike dhe sociale të lidhura me atë dhe nevoja urgjente për pajtim politik në rajon me qëllim të arritjes së një stabiliteti më të madh për tërë Evropën. Në lidhje me secilën nga këto sfida, ju uroj juve dhe ekipit të LDK-së të gjitha të

mirat dhe shumë suksese. Jam i bindur se do të udhëzoheni nga vlerat tona të EPP-së dhe se parimet e sundimit të ligjit, pavarësia e gjyqësorit dhe lufta kundër korrupsionit do të jenë të larta në agjendën tuaj. Dialogu me Beogradin gjithashtu duhet të rifillohet me energji të re: me të vërtetë, duket se tani është një moment i ri për këtë", ka thënë Tusk në letrën e tij drejtuar Hotit.

Ai ka theksuar se EPP-ja është e lumtur që në familjen e saj ka LDK-në si anëtare, parti e themeluar nga Ibrahim Rugova dhe e udhëhequr tani nga lidërshipi i Isa Mustafës. "Shpresojmë të shohim dhe mezi presim të shohim, në të ardhmen, gjithashtu, një LDK të fortë dhe të bashkuar në shërbim të interesave më të mira të Kosovës dhe qytetarëve të saj", ka thënë presidenti i Partive Popullore Evropiane (EPP), Donald Tusk.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, BLERAND STAVILECI

PDK-ja, MODEL OPOZITARIZMI KUNDËR



Drejtori ekzekutiv i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, ka bërë me dije se opozitarizmi i kësaj partie do të jetë model i një politikëbërjeje të re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se aktiviteti i PDK-së gjatë këtij mandati do të jetë në dy drejtime. Stavileci ka treguar se kjo parti do të prezantojë skema të mirëfillta ekonomike dhe sociale të rimëkëmbjes në dobi të qytetarëve dhe do t’i shkojë deri në fund demaskimit të politikave populiste. Sipas tij, edhe ish-kryeministri Kurti dhe kryeministri Hoti kanë marrë besimin qytetar duke e mashtruar me retorika e simbolika boshe

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Drejtori ekzekutiv i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerand Stavileci, ka thënë se kjo parti, duke parë me shqetësim zhvillimet dhe lëvizjet e fundit politike në vend, ka prezantuar platformën e rimëkëmbjes kombëtare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka theksuar se qeveritë e fundit, e vjetra e Kurtit dhe kjo e reja e vjetër e Hotit, janë të

ngjashme në kuptimin e asaj se çka përfaqësojnë. “E tërë odisejada e këtyre muajve të fundit, e cila zgjati më shumë se katër muaj për ta ndërtuar një trohë besimi, dhe iu deshtë më pak se dy muaj për ta tradhtuar keq njëri-tjetrin dhe qytetarin e vendit tonë, përbën një arsye të fortë që të tillët as të mos votohen e as të mos përkrahen. Mbollën mashtrimin, e korrën mashtrimin”, ka deklaruar Stavileci.

Ai ka thënë se opozitarizmi i PDK-së do të jetë model i një

politikëbërjeje të re, i cili, nga njëra anë do të prezantojë skema të mirëfillta ekonomike dhe sociale të rimëkëmbjes në dobi dhe për dobi të shtetit e qytetarëve tanë, nga ana tjetër do t’i shkojë deri në fund demaskimit të politikave populiste të atyre që marrin besimin qytetar duke e mashtruar pikërisht atë besim me retorika e simbolika boshe. “Hija e mashtruesve do t’i përcjellë deri në fund dhe nuk do të mund t’i ikin asaj. Kjo e bën më të lehtë udhëtimin tonë

QEVERIVE TË MASHTRIMIT KURTI - HOTI



adresë dhe prijëse e proceseve shtetndërtuese dhe shtetzhvilluese, ka prezantuar Platformën e Rimëkëmbjes Kombëtare.

“Epoka e re”: *Cila ka qenë arsyeja dhe urgjenca e bërjes dhe prezantimit të saj?*

Stavileci: Të gjithë qytetarët e vendit tonë e dinë se që nga shpallja e pavarësisë e deri në vitin 2014 nën udhëheqjen e PDK-së janë realizuar shumë punë e projekte madhore për shtetin tonë, të cilat kanë bërë që shumë sektorë vitalë ta ndiejnë transformimin e duhur në dobi të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve, nga kryeveprat infrastrukturore e deri te rritja e pagave për të gjitha kategoritë e shoqërisë sonë. Fatkeqësisht, nga viti 2014 e këndeje, si rezultat i aventurave të rrezikshme politike të partive, që tjetër gjë proklamoni e krejtësisht tjetër gjë bënin, nga pseudokauzat nacionaliste e patriotike, siç ishte demarkacioni, e deri te premtimet boshe për shtresat e ndryshme të shoqërisë, ne kemi parë vetëm patriotizëm folklorik dhe patetizëm ekonomik, i cili kulmoi gjatë muajve të fundit me dy destinacione tejet të rrezikshme për shtetin tonë të dashur. E para, ftohja dhe prishja e marrëdhënieve me partnerin tonë kryesor strategjik, ShBA-në. Dhe, e dyta, rrezikimi i kolapsit ekonomik në kohën e pandemisë si rezultat i masave joadekuate dhe të mangëta për ekonominë, sektorin privat dhe sektorin publik, të qeverisë Kurti, e cila në 52 ditë qeverisje jo vetëm që u dëshmuar e pavizion, e paaftë dhe e paguximshme, por bëri gabime trashanike, të rrezikshme e të pafalshme për të ardhmen e vendit tonë dhe qytetarëve të tij të çmuar. Prandaj, ishte koha dhe momenti që, edhe pas instalimit të qeverisë së re, e cila vuan nga po i njëjti virus, ai i mashtrimit, PDK-ja, si gjithmonë, të dilte në ballë të një procesi të ri, i cili do ta sendërtojë rimëkëmbjen kombëtare, duke e kthyer Kosovën në rrugën e saj të drejtë.

Angazhimi ynë është për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve kudo, moscenimin e kufijve të Kosovës, ruajtjen e lirisë dhe mbrojtjen e vlerave çlirimtare të popullit tonë. Orientimi ynë është djathtist, që promovon të drejtat dhe liritë qytetare dhe lufton për to. Ekonomia e tregut të lirë dhe e

konkurrencës së ndershme është princip bazë i angazhimit tonë. Më pak fuqi qeverisë dhe politikanëve, e më shumë fuqi ndërmarrësve dhe të rinjve. Më pak burokraci në vendimmarrje, më pak procedura dhe më pak tatime. Më shumë përkrahje prodhimit, eksportit dhe punësimit. Paralelisht me këtë mendësi ekonomike, mposhtja e së keqes është domosdoshmëri në kuadër të reformave për drejtësi, ligj dhe mirëqeverisje. Korrupsioni, abuzimi, mashtrimi duhet të ndalen një herë e përgjithmonë. Këto janë qëllimet dhe vlerat kryesore të platformës sonë.

“Epoka e re”: *Ju keni marrë pozitën e drejtorit ekzekutiv në PDK. A mund të na tregoni se cili është roli i kësaj pozite dhe deri ku ka shkuar procesi i reformave të brendshme në këtë parti?*

Stavileci: PDK-ja jo vetëm në rrafshin institucional, por edhe në atë të brendshëm organizacional është dëshmuar si kampione e proceseve shembullore e demokratike të transformimit bashkëkohor, në hap me trendët e kohës dhe në përputhje me zhvillimet e fundit teknologjike dhe informative. Përveçse kemi zhvilluar zgjedhje të brendshme model, kemi bërë edhe riorganizime strukturore e funksionale, që u shkojnë për shtati partive të mëdha e serioze të ideologjisë së djathtë politike, pjesë e familjes së të cilave tashmë jemi fuqishëm në të gjitha aspektet. Në këtë drejtim kemi parë të arsyeshme që, përveç strukturave të mirëdefinuara e të konsoliduara partiake, të kemi edhe disa njësi e pozita që u shërbejnë më mirë kërkesave të kohës dhe nevojave partiake, me theks të veçantë në pjesën e organizimit dhe komunikimit. Pozita e drejtorit ekzekutiv ka të bëjë kryesisht me këto fusha, por edhe me fusha të tjera nga administrata e deri te çështjet e ndryshme politike që janë pjesë e spektrit të punës dhe strategjisë së subjektit tonë politik.

“Epoka e re”: *PDK-ja ka votuar kundër formimit qeverisë Hoti. Pse ka votuar kundër?*

Stavileci: Partia jonë ka një kurs të përcaktuar politik, të kultivuar ndër vite, duke i mbetur besnike vlerave tona dhe duke krijuar vlera të reja moderne që i duhen vendit dhe

qytetarëve, që të kemi zhvillim ekonomik, rritje të mëtutjeshme të mirëqenies së qytetarëve dhe rivendosje të partneritetit të mirëfilltë me aleatët tanë perëndimore në krye me ShBA-në. Qëndrimet tona për të gjitha këto kanë qenë më stabilet dhe më konsistentet nga të gjitha partitë politike. Qeveritë e fundit, e vjetra e Kurtit dhe kjo e reja e vjetër e Hotit, janë të ngjashme në kuptimin e asaj se çka përfaqësojnë. Josinqeritet, mosbesim, tradhti dhe mashtrim. E tërë odisejada e këtyre muajve të fundit, e cila zgjati më shumë se katër muaj për ta ndërtuar një trohë besimi, dhe iu deshtë më pak se dy muaj për ta tradhtuar keq njëri-tjetrin dhe qytetarin e vendit tonë, përbën një arsye të fortë që të tillët as të mos votohen e as të mos përkrahen. Mbollën mashtrimin, e korrën mashtrimin. Maskat e tyre prej demagogësh e populistësh ranë shumë shpejt, por shumë më herët sesa që edhe prognozuesit më optimistë do të mund ta parashikonin. Prandaj, si Kurti si Hoti, janë dy anë të së njëjtës monedhë politike, asaj të mashtrimit, e cila duhet të konfiskohet e ndëshkohet politikisht sa më parë që të jetë e mundur.

“Epoka e re”: *Cila do të jetë mënyra e PDK-së si parti opozitare për ta kundërshtuar këtë qeveri?*

Stavileci: Opozitarizmi ynë do të jetë model i një politikëbërjeje të re, i cili, nga njëra anë, do të prezantojë skema të mirëfillta ekonomike dhe sociale të rimëkëmbjes në dobi dhe për dobi të shtetit e qytetarëve tanë dhe, nga ana tjetër, do t'i shkojë deri në fund demaskimit të politikave populiste të atyre që marrin besimin qytetar duke e mashtruar pikërisht atë besim me retorika e simbolika boshe. Mashtruan popullin, mashtruan njëra-tjetrën. Hija e mashtruesve do t'i përcjellë deri në fund dhe nuk do të mund t'i ikin asaj. Kjo e bën më të lehtë udhëtimin tonë të ri politik opozitar ngase PDK-ja është e vërtetë se ashtu siç ka bërë punë të mira për vendin, ndonjëherë edhe ka bërë lëshime, por asnjëherë nuk ka mashtruar siç mashtruan Kurti dhe Hoti. Kjo qysh tani e bën diferencën në skenën tonë politike për të ardhmen e besimit qytetar. Ata nuk do të pranojnë të mashtrohen e të tradhtohen. Dhe ky sentiment i ri është një arsye shumë e madhe më tepër që sytë e tyre të kthehen nga Partia Demokratike e Kosovës dhe platforma e saj për rimëkëmbjen.

të ri politik opozitar ngaqë PDK-ja është e vërtetë se ashtu siç ka bërë punë të mira për vendin, ndonjëherë edhe ka bërë lëshime, por asnjëherë nuk ka mashtruar siç mashtruan Kurti dhe Hoti. Kjo qysh tani e bën diferencën në skenën tonë politike për të ardhmen e besimit qytetar. Ata nuk do të pranojnë të mashtrohen e të tradhtohen. Dhe ky sentiment i ri është një arsye shumë e madhe më tepër që sytë e tyre të kthehen nga Partia Demokratike e Kosovës

dhe platforma e saj për rimëkëmbjen”, ka deklaruar Stavileci.

“Epoka e re”: *Z. Stavileci, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, më 10 qershor në Prizren ka shpallur një platformë të cilën e ka quajtur platformë të rimëkëmbjes kombëtare. Çka nënkupton kjo platformë?*

Stavileci: Duke parë me shqetësim zhvillimet dhe lëvizjet e fundit politike në vendin tonë, Partia Demokratike e Kosovës si

Brenda disa ditësh FSK-ja fillon kampanjën e rekrutimit

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) pret që javën e ardhshme ta fillojë kampanjën informuese të rekrutimit për akademinë ushtarake.

Megjithëse pandemia Covid-19 ka prekur edhe në organizmin e aktiviteteve të Forcës, institucioni është në hap me planin e paraparë vjetor.

Komandanti i Forcës, gjeneraljtënant Rrahman Rama, në një intervistë për "KosovaPress" ka treguar kur pritet të nis vitin e ri akademik me kadetët e rinj, ndërkohë flet edhe për pranimin e kadetëve në pesë vende partnere.

FSK-ja do të realizojë dy fushata informuese për pranimin e ushtarëve të rinj, të cilat do të nisnin me atë për pranim në Qendrën Universitare ku është një numër më i kufizuar i pranimit. "Ne shumë shpejt, besojmë në javën e ardhshme, do ta bëjmë kampanjën e rekrutimit dhe konkursi do të jetë i hapur për akademinë tonë këtu, por edhe për pesë vende të tjera që kemi oferta nga partnerët tanë. Jemi me kohë për shkak se edhe testi kombëtar është shtyrë për korrik dhe pas marrjes së diplomave, certifikatave nga ana e aplikantëve, plani ynë është që t'i kryejmë të gjitha obligimet, qofshin ato kampanja të rekrutimit, përzgjedhje të seleksionimit, dhe të njëjtën kohë t'i zhvillojmë të gjitha procedurat e përzgjedhjes dhe seleksionimit dhe besojmë që do të jemi të gatshëm që në shtator ta fillojmë vitin e ri akademik me kadet të rinj", ka thënë gjeneral Rama.

Në kuadër të kësaj fushate hyn edhe konkursi për pranim në akademi ushtarake të vendeve partnere Gjermania, Turqia, Kroacia, Maqedonia, ndërkohë që në Angli dy pjesëtarë të Forcës tashmë kanë shkuar për shkollim në Akademinë

Mbretërore Ushtarake Sandhurst.

Akademia Ushtarake e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me koncept amerikan, tashmë është e akredituar dhe e ka programin tërësisht në gjuhën angleze.

Gjeneral Rama thotë se u ofrojnë hapësirë për shkollim edhe vendeve të rajonit si Shqipëria, Maqedonia e Mali i Zi, meqë tashmë është akademi regjionale.

Procesi i aplikimit dhe pranimit në Forcë do të bëhet nën masat e rekomanduara nga institucionet shëndetësore.

E kampanja e dytë e cila është planifikuar të fillojë në korrik do të jetë për ushtarë të rinj, ku numri i të pranuarve do të jetë 400. "Kampanjën e dytë kemi planifikuar të fillojmë në korrik. Do të jetë për rekrutë të rinj, ose ushtarë të rinj. Do të jenë 400 rekrutë të rinj dhe mbi bazën e planit tonë ne kemi planifikuar që gjatë muajit korrik ta shpallim konkursin, t'i kemi aplikantët dhe deri në shtator t'i kryejmë procedurat e përzgjedhjes dhe në shtator ta fillojmë trajnimin bazik që është një trajnim 9 javor. Të gjithë ata që i kalojnë këto kritere, e kalojnë trajnimin bazik do të jenë pjesë aktive të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga 1 janari i vitit të ardhshëm. Pandemia nuk ka ndikuar në këtë proces, sepse ky ka qenë planifikimi ynë", thotë ai.

Komandanti i FSK-së thotë se tri javë më parë kanë filluar punën me personel qind për qind dhe ka dhënë urdhër që të arrihet afati kohor i planifikuar në planin vjetor. "Kemi disa kontrata dhe presim disa furnizime që janë shumë të rëndësishme për Forcën dhe vendin tonë, që ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve të reja dhe në operacionalitet të njëjësive të thirrura, bazuar në ligj dhe rregulloret që i kemi", thotë ai.

Në këtë kohë të pandemisë kanë ardhur lajme të mira nga Forca e



Sigurisë së Kosovës. Të shtunën kanë dalë të diplomuarit e parë nga academia prestigjioze në West Point, dy pjesëtarë të Forcës të cilët katër vjet më parë nisën

shkollimin atje.

Gjithashtu, FSK-ja ka tre kadetë të rinj që sivjet fillojnë shkollimin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dy West Point dhe për herë të

parë një kadet në Forcat Ajrore të ShBA-së. Në mundësinë e parë kur funksionalizohen fluturimet ata do të udhëtojnë për në Shtetet e Bashkuara.

Kurti kërkon mbështetjen e mërgatës për peticionin 'Duam zgjedhje'

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Lëvizja Vetëvendosje ka organizuar takim virtual me bashkëbisedues nga mërgata për të diskutuar për 21-vjetorin e çlirimit të Kosovës dhe 15-vjetorin e këtij subjekti politik.

Në këtë takim morën pjesë kryetari i LV-së, Albin Kurti, sekretarja organizative Vlora Haxhimehmedi dhe deputetja Fitore Pacolli, ndërsa takimi u

moderua nga Lirika Komoni, koordinatorë e qendrave në mërgatë.

Vlora Haxhimehmedi, duke folur për rritjen e mbështetjes ndaj Lëvizjes njoftoi, ndër të tjera, edhe shtrirjen më të madhe të LV-së në Kosovë dhe jashtë saj. Ajo, po ashtu, foli edhe për historikun e organizimit të lëvizjes përgjatë 15 vjetëve të ekzistencës së saj.

Në anën tjetër, Fitore Pacolli u fokusua te vendimet që qeveria Kurti kishte ndërmarrë në lidhje



me mërgatën që nga vendimi për fillimin e procedurave për pagesën e Kartonit të Gjellbër për bashkatdhetarët që vijnë në vendlindje, te ligji i diasporës dhe për nismën ligjore për

votimin e mërgatës nëpër ambasada dhe konsullata, që u propozua nga deputetët e Lëvizjes ditë më parë.

Në fund, kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje i informoi bashkëbiseduesit nga mërgata për situatën politike në vend, për 100 ditëshin e qeverisë së mirë, për rëndësinë dhe mbështetjen e madhe për peticionin "Duam zgjedhje" si dhe përgatitjet për zgjedhjet lokale. "Me një interesim të jashtëzakonshëm, mes qindra

kërkesash për pjesëmarrje në këtë takim virtual, këtë herë nuk arritëm që t'i përfshijmë të gjithë bashkatdhetarët në këtë bisedë për çka edhe ju kërkojmë ndjesë, ndërkaq ju njoftojmë që së shpejti Lëvizja do të organizojë takime të ngjashme përsëri për të cilat do t'ju tregojmë me kohë. Lëvizja Vetëvendosje përherë i është falënderuese mërgatës për kontributin dhe rolin pasohq të saj që ka në raport me Kosovën, atdheun tonë të përbashkët", bëhet me dije në njoftimin e LV-së.

Intervistë me drejtorin e shkollave “Mehmet Akif”, Nazmi Ullus

Edhe pse kohë pandemie, ka një interesim të jashtëzakonshëm për shkollat ‘Mehmet Akif’ dhe ‘ISP’

Drejtori i shkollave “Mehmet Akif”, Nazmi Ullus, ka theksuar se si në të gjithë botën, edhe institucionet arsimore në Kosovë janë zënë të papërgatitura ndaj pandemisë Covid-19. Në intervistën dhënë për gazetën “Epoka e re”, Ullus ka thënë se shkollat “Mehmet Akif” dhe “ISP” kanë marrë vendime radikale për t’u adoptuar me situatën e re pas vendimit të qeverisë më 11 mars për ndërprerjen e procesit mësimor. “Mund të them me krenari se asnjë nxënës, duke nisur nga moshat më të vogla (parashkollor) deri në klasën 12, i shkollave ‘Mehmet Akif’ dhe ‘ISP’ nuk ka humbur asgjë nga procesi mësimor. Jemi krenarë dhe të lumtur se si një nga institucionet më prestigjioze në vend nuk i braktisëm dhe nuk i zhgënjëm prindërit dhe nxënësit tanë”, ka deklaruar Ullus



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 QERSHOR -

“Epoka e re”: Z. Ullus, sa ka shkaktuar dëme në aspektin edukativo-arsimor situata e pandemisë Covid-19 në shkollat “Mehmet Akif”?

Ullus: Si në të gjithë botën, edhe institucionet arsimore në Kosovë janë zënë të papërgatitura ndaj pandemisë dhe karantinës. Mësimi online (në distancë) i cili është përdorur më parë në mënyrë të kufizuar dhe vetëm në arsimin universitar, papritur u shndërrua në një shpëtimtar të momentit dhe shpresa e shkollimit për të gjitha grup moshat nga më të vegjlit deri të më të mëdhenjtë.

Edhe ne si Këshill Drejtues i shkollave “Mehmet Akif” dhe “ISP” morëm vendime radikale për t’u adoptuar me situatën e re pas vendimit të qeverisë më 11 mars për ndërprerjen e procesit

mësimor. Menjëherë thirrëm në takim urgjent konsultativ stafin drejtues të të gjitha shkollave dhe bëmë përgatitjet e duhura që më 16 mars të gjitha shkollat të ishin gati për nisjen e mësimi online. Në periudhën e shkurtër 3-4 ditore organizuam seminare, udhëzime dhe mbështetje profesionale për mënyrën e zhvillimit të mësimi online.

Pas rekomandimeve dhe mendimeve për zhvillimin e mësimi sipas modeleve të disa shkollave publike apo private me anë të videove apo linçeve ne vendosëm organizimin e mësimi interaktiv, që do të thotë lidhja me nxënësit në mënyrë direkte, mundësia e mësimdhënësit të ndërhyjë gjatë mësimi, të bëjë pyetje rreth zhvillimit të mësimi. Pikërisht kjo ka qenë risia dhe veçoria dalluese jona në ndryshim me institucionet e tjera. Pasi përfunduam kualifikimin apo trajnimin e mësimdhënësve, hartuam

orarin e ri mësimor dhe në një kohë rekord dolëm para nxënësve të gatshëm pa humbur kohë dhe duke respektuar planprogramet mësimore të miratuara nga MASH-T-i. Mund të them me krenari se asnjë nxënës, duke nisur nga moshat më të vogla (parashkollor) deri në klasën 12, i shkollave “Mehmet Akif” dhe “ISP”, nuk ka humbur nga procesi mësimor. Jemi krenarë dhe të lumtur se si një nga institucionet më prestigjioze në vend nuk i braktisëm dhe nuk i zhgënjëm prindërit dhe nxënësit tanë.

“Epoka e re”: A keni pasur vështirësi rreth organizimit të mësimi online dhe sa keni qenë të kënaqur nga ky projekt?

Ullus: Unë në këtë pikë do të falënderoja në mënyrë të veçantë stafin mësimdhënës. Me një përkushtim maksimal u dolën zot punëve dhe nxënësve. Natyrisht që kryerja dhe vazhdimësia e punëve kërkon

një angazhim të gjithanshëm. Sidoqoftë kolegët e mi janë treguar të mrekullueshëm dhe të suksesshëm. Nuk duhet harruar edhe falënderimi për prindërit tanë që u qëndruan pranë fëmijëve gjatë kohës (screen time) që ata zhvillonin mësimin online (para ekraneve të kompjuterëve apo telefonave), sepse kjo është diçka e vështirë për fëmijët e sotëm. Edhe ata u bënë pjesë e këtij procesi dhe shumë prej tyre vijën nga fusha e edukimit. Si përfundim mund të them se tabloja finale është e kënaqshme për të gjithë. Kjo shihet edhe nga numri i regjistrimeve të reja për vitin e ardhshëm. Ka një interesim të jashtëzakonshëm dhe në rritje sepse të gjithë e kanë kuptuar që “Mehmet Akif” dhe “ISP” nuk të lënë në baltë.

“Epoka e re”: Nxënësit tuaj sa kanë arritur të mësojnë nga sistemi i MASH-T-i përmes TV-së apo keni organizuar mësimin online nga mësuesit dhe arsimtarët tuaj?

Ullus: Ne kemi organizuar dhe ushtruar sistemin tonë gjatë kësaj periudhe. Një nxënës është në gjendje të gjejë, të shohë çfarëdo video në youtube, por në qoftë se nuk krijohet një situatë nxënie interaktive reale apo afër reales, nuk mund të bëhet fjalë për realizim të procesit mësimor. Ne kemi përdorur platformën Zoom, platformë që përdoret gjerësisht në botë dhe çdo mësimdhënës ka pasur llogarinë e vet.

“Epoka e re”: Tashmë jemi në prag të regjistrimit të nxënësve të rinj. A prisni të keni vështirësi në arritjen e numrit të nxënësve kur

dihet që situata ekonomike si shkak i pandemisë ka prekur edhe xhepat e prindërve që i kanë ose pretendojnë t’i kenë fëmijët pjesë e institucioneve shkollore të “Mehmet Akif”?

Ullus: Po ashtu, siç e parashtuar edhe ju, ne jemi në sezonin e regjistrimeve. Siç e thashë më parë, jemi përballë një tabloje të kënaqshme ku rriten vazhdimisht interesimi dhe kërkesat. Duket qartë se do t’i kalojmë shifrat e vitit të kaluar. Ne jemi të vetëdijshëm për ndikimin e pandemisë në gjendjen ekonomike të familjeve dhe individëve, prandaj edhe kemi ofruar plan pagesa dhe alternativa lehtësuese.

“Epoka e re”: A do të ketë ndonjë lehtësim rreth pagesave apo çmimeve gjatë vitit shkollor 2020/21?

Ullus: Ne jemi shkolla private, por që nuk hyjmë në grupin e shkollave shumë të shtrenjta. Siç e ceka më sipër, ne ofrojmë alternativa dhe lehtësira në pagesa, pa harruar bursat për nxënësit e suksesshëm.

“Epoka e re”: Sa jeni përgatitur për vitin e ri shkollor?

Ullus: Që nga ky çast objektivi ynë më i madh është hapja e shkollave dhe ribashkimi me nxënësit në shtator. Për këtë kemi bërë përgatitjet që tani. Gjatë sezonit të verës do të vazhdojë trajnimi i mësimdhënësve. Mendoj se kemi qenë të suksesshëm në mësimin online dhe për këtë them se jemi markë. Pavarësisht se jemi të kënaqur me ato çfarë kemi arritur mendoj se do të mbetet “Shkolla është e bukur me nxënës”.



A mund t'i marrin kontributpaguesit paratë e Trustit Pensional?

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në programin qeverisës, në një nga masat e pakos së rimëkëmbjes ekonomike, ka paraparë ta fusë në ekonomi një përqindje të Fondit të Kursimeve Pensionale. Siç ka deklaruar Hoti, kjo qeveri ka paraparë nëntë masa të pakos për rimëkëmbje ekonomike. Masa e pestë, siç ka thënë Hoti, parasheh që një përqindje e parave të kontributpaguesve në Trustin Pensional t'i kalojnë kontributpaguesit. "Masa e pestë për stimulim të kërkesës agregate. Këtu planifikojmë kthimin e një përqindje të mjeteve të kursyera të Trustit Pensional për kontributpagues bazuar në nevojat e tyre e cila mundësi mund të shfrytëzohet për një periudhe tremujore, ndërsa shteti e mbulon brenda disa viteve", ka thënë Hoti në fjalimin e tij para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Stimulimi i kërkesës agregate nënkupton rritjen e shpenzimeve që eventualisht do ta bënin qytetarët pas marrjes së parave nga kontributet pensionale.

Të gjithë të punësuarit (e regjistruar) në Kosovë paguajnë 10 për qind kontribute pensionale nga paga e tyre, përkatësisht pesë për qind paguan punëdhënësi, kurse pesë për qind paguhen nga paga e të punësuarit.

Deri më tani 2 miliardë euro ka arritur vlera e mjeteve të rreth 700 mijë kontributpaguesve në Kosovë që i menaxhon Fondi i Kursimeve Pensionale. Nga kjo vlerë, 75 për qind e mjeteve mbahen të investuara në tregjet financiare ndërkombëtare,



kurse 25 për qind në Kosovë. Prej themelimit e deri më 5 qershor, kthimi bruto nga investimi i mjeteve të trustit pensional të investuar ka arritur në rreth 470 milionë euro.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) është institucion publik i pavarur dhe jo fitimprurës, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ky Fond është krijuar sipas modelit të kontributeve pensionale të definuara, që nënkupton se secili kontribuues kursen për pension në një llogari personale.

Administrimi i këtyre llogarive individuale është përgjegjësi ligjore, megjithëse paratë e

kursyera mbesin pronë vetjake e kontribuuesve.

Edhe pse në pronë private, mandati i këtyre kursimeve është specifik ngaqë ato me legjislacionin në fuqi mund të përdoren vetëm për pension dhe nuk mund të përdoren ose tërhiqen përpara moshës së pensionimit për asnjë arsye tjetër.

Jeton Demi, zëdhënës në këtë institucion, përmes një përgjigje me shkrim i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se kjo çështje aktualisht është vetëm ide.

Por, ai ka shtuar se Trusti i Kursimeve Pensionale është institucion zbatues i politikave që ndërmarrin institucionet

mbikëqyrëse, pra Kuvendi i Kosovës dhe Banka Qendrore. "Nëse merret vendim për zbatimin e tij, Trusti obligohet ta implementojë", ka thënë Demi. Për t'u realizuar kjo masë e cila ka të bëjë me kthimin e një përqindjeje të fondit në llogari të kontributpaguesve, duhet ndryshuar baza ligjore, thotë Mejditi Bekatshi, profesor në Universitetin e Prishtinës. Ai në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" thotë se kjo masë do ta rriste kërkesën agregate me qëllim që bizneset apo sektori i tregtisë mos të zhytet në krizë. Sipas tij, është një masë e cila do të ndihmonte në ekonomi. "Kjo është një masë që të gjitha qeveritë në botë e

përdorin, me të vetmin qëllim që ta rrisin kërkesën agregate. Nga ajo që është thënë në masën e kryeministrit nuk është e qartë se si do të zbatohet kjo masë, por së pari duhet të ndryshohet Ligji për Trustin për ta parë se si mund të përdoren mjetet", thotë ai.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, thotë për Radion Evropa e Lirë se kthimi i një përqindjeje të mjeteve të kursyera të Trustit Pensional për kontributpagues do të ishte me efekte pozitive në ekonomi.

Ai beson se ndryshimet ligjore që duhet bërë për të përdorur këto mjete do të arrihen të bëhen në Kuvendin e Kosovës.

"Përshkrimi që i është bërë kësaj mase nga ana e qeverisë së re ka për qëllim stimulimin e kërkesës agregate, rritjen e shpenzimit të konsumatorëve, ofrimin e mundësive që ata të kenë në dispozicion një shumë të caktuar të mjeteve që, siç e ka sqaruar kryeministri, mund të përdoret për shpenzime ditore", tha Zeka. Ai thotë se edhe pse pakoja e rimëkëmbjes nuk e përmend shumë që mund të tërhiqet, sipas sqarimeve, thotë Zeka, bëhet fjalë për një 10 për qind të mjeteve të kursyera, që në total i bie deri në 200 milionë euro, e të cilat do të ishin një infuzion shumë i rëndësishëm për ekonominë.

Parashikimet e mekanizmave financiarë ndërkombëtarë për efektet që do t'i ketë pandemia e koronavirusit në ekonominë e Kosovës janë të zymta.

Banka Botërore në raportin e saj ka paraparë një rënie ekonomike prej 4.5 përqindësh në Kosovë.

Rukiqi: Privatizimi i Telekomit dhe themelimi i Gjykatës Komerciale, të domosdoshme

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Qeveria e re duhet ta formojë sa më parë Gjykatën Komerciale për të pasur siguri juridike, pasi mungesa e sundimit të ligjit mbetet një ndër arsyet kryesore pse nuk ka investime në Kosovë. Kështu ka thënë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, i cili ka mirëpritur planin e qeverisë Hoti për trajtimin e ndërmarrjeve publike, veçanërisht për privatizimin e Telekomit të Kosovës.

Rukiqi ka thënë për "Kosovapress" se për të mos

pasur pakënaqësi sociale te qytetarët, qeveria sa më parë ose deri në fund të këtij muaj duhet t'i implementojë tërësisht masat e Pakos Emergjente Fiskale për ta filluar rimëkëmbjen ekonomike nga korriku. Sipas tij, Kosova është një ndër vendet që ka pësuar më së shumti nga pandemia Covid-19 dhe pritjet e sektorit privat nga qeveria e re, ndërliken me veprimet e rimëkëmbjes ekonomike.

Lidhur me vonesat e zbatimit të Pakos Emergjente, veçanërisht

për punëtorët dhe bizneset, kryetari i OEK-ut ka thënë se, edhe pse ka humbur kuptimin pakoja "e famshme" emergjente, deri në fund të këtij muaji duhet të impementohet e tëra për të filluar nga korriku me masat e rimëkëmbjes.

Kryetari i OEK-ut ka vlerësuar programin e qeverisë për trajtimin e ndërmarrjeve publike, sidomos privatizimin e Telekomit dhe për sundim të ligjit që lidhen me Gjykatën Komerciale e cila ka ngecur në vazhdimësi.



Hoti: Në ditët në vazhdim do të shohim një energji të re të qeverisë për ta ndaluar rënien ekonomike

**EPOKA
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se java e parë e shërbimit në zyrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës ishte një sinjal i qartë i përkushtimit, punës dhe partneritetit. Ai ka thënë se si qeveri e kanë bërë publik projektin për rimëkëmbje ekonomike si dhe për luftimin e

Covid-19. "Po ashtu, e kemi bërë publik para opinionit, partnerëve të koalicionit dhe atyre ndërkombëtarë platformën tonë për dialogun me Serbinë. I përkushtuar për konsensus politik, ftova miqësisht dhe institucionalisht opozitën. I falënderoj partnerët e koalicionit për përkushtimin në këtë proces dhe vullnetin e tyre për bashkërendim. Në anën tjetër, pres nga opozita mirëkuptim dhe

gatishtëri për të diskutuar e bashkërenduar veprimet e qëndrimet e shtetit të Kosovës lidhur me dialogun në të ardhmen", ka thënë Hoti.

Ai ka shtuar se përkushtimi i tyre për ta promovuar subjektivitetin e vendit dhe për të ruajtur integritetin e tij, janë synime të përbashkëta që ndajnë edhe me miqtë ndërkombëtarë. "Takimet me ambasadorët e Quintit si dhe bisedat telefonike konstruktive e

të hapura me administratën Trump në Uashington, me Brukselin, Berlinin e Parisin, ishin hapi i parë, por shumë i rëndësishëm për t'i kthyer në normalitet marrëdhëniet tona të dëmtuara jo pak në të shkuarën e afërt. Në ditët në vazhdim të gjithë do të shohim një energji të re të qeverisë për ta ndaluar rënien ekonomike dhe për ta nxjerrë atë në bregun e normalitetit dhe përparimit, një përkushtim për të

promovuar dhe monitoruar masat anti-Covid, të cilat janë jetike për mbrojtjen e shëndetit publik dhe ekonomisë, si dhe një vullnet për t'i ulur heshtat e luftës së pakuptimtë politike, e cila çdo ditë e më shumë po kthehet qëllim në vetvete e jo në mbrojtje të interesit qytetar. Qëllimi ynë është kthimi i normalitetit dhe zhvillimi, e për këtë na duhet shumë punë e përkushtim", ka thënë kryeministri Hoti.



Bizneset nuk morën paratë e premtuara gjatë pandemisë

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Pakoja emergjente fiskale në vlerë prej 180 milionë eurosh, e cila kishte për qëllim t'i zbusë problemet ekonomike dhe sociale, ende nuk ka arritur të shpërndahet te bizneset dhe punëtorët. Kjo pako ishte miratuar në muajin mars nga qeveria Kurti për nevojë emergjente të qytetareve dhe bizneseve.

Disa nga masat kishin filluar të zbatohen, por tani pas ardhjes së qeverisë të udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti, pakoja thuhet se nuk mund të zbatohet pasi që nuk ka mjete financiare.

Zëdhënësi i Ministrisë së Financave dhe Transfereve, Muharrem Shahini, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se janë në proces të rishikimit të buxhetit dhe se me buxhetin e rishikuar do të sigurohen fondet. "Me buxhetin e rishikuar, i cili pritet të shkojë së shpejti për aprovim në qeveri, pastaj në Kuvend, do të sigurohen fonde të mjaftueshme për

implementimin e plotë të pakos fiskale emergjente", ka thënë Shahini.

Arsyeja e vonesave të shkaktuara deri më tani rreth Pakos Fiskale Emergjente, thotë Shahini, rrjedh prej faktit se disa nga masat e zotuar nuk kanë qenë të përfshira brenda linjave të buxhetit. Po ashtu, ai shton se ka pasur edhe gabime në plotësimin e aplikacioneve të bëra nga aplikantët dhe kjo ka rritur volumin e punës së Komisionit për Shqyrtimin e Aplikimeve. "Në buxhetin e rishikuar, përveç financimit të Pakos Emergjente Fiskale, do të përfshihet edhe financimi i programit për rimëkëmbje ekonomike i cili synon ta rrisë ndjeshëm financimin e aktivitetit ekonomik në vendin tonë. Presim që buxheti i rishikuar të procedohet në Kuvend brenda disa ditësh", ka thënë Shahini.

Për t'iu dalë në ndihmë bizneseve dhe kategorive të tjera të shoqërisë të prekura pas



përhapjes së koronavirusit, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Transfereve pati miratuar Pakon Emergjente Fiskale në vlerë prej 179.6 milionë eurosh.

Në seancën e Kuvendit të Kosovës më 11 qershor, ministrja e Financave dhe Transfereve, Hykmete Bajrami, ka bërë me dije se nga 180 milionë euro të pakos emergjente janë shpenzuar vetëm rreth 60 milionë euro, pasi nuk ka mjete

financiare pa u bërë ndryshimet ligjore dhe rishikimi i buxhetit.

Përfaqësues të bizneseve thonë se kanë pasur ankesa të shumta që kanë ardhur nga afaristët sa iu përket kompensimeve që është dashur t'u bëhen bizneseve nga pakoja emergjente për pagat e punëtorëve dhe qiranë.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, tha për "Radion Evropa e Lirë" se bizneset nuk kanë marrë ndihmën e premtuar nga pakoja

emergjente fiskale. Ai thotë se nuk e dinë nëse bëhet fjalë për një planifikim jo të mirëfilltë, por shton se është inkurajuese që tani qeveria e re ka thënë se do të marrë për obligim t'i zbatojë të gjitha masat e përfshira në pakon fiskale. "Gjatë ditëve të kaluara kemi pasur një numër të madh të ankesave të bizneseve sa i përket marrjes së kompensimit edhe për paga edhe qiranë. Masa që kishte të bënte me mbulimin e 50 për qind të shpenzimeve të qirave e nuk ishte zbatuar asnjëherë nga ana e qeverisë së kaluar", ka thënë Zeka.

Ai thotë se duhet të kuptojnë të gjithë dhe ta fillojnë zbatimin e masave të pakos emergjente pasi janë të domosdoshme për mbijetesën e shumë bizneseve në Kosovë. Derisa pakoja e parë emergjente fiskale ende nuk është zbatuar në tërësi, Qeveria e Kosovës thotë të jetë në proces për pakon e dytë fiskale e cila në fokus do ta ketë rimëkëmbjen ekonomike.

Drenasi feston Ditën e Çlirimit

DRENAS, 14 QERSHOR (ER) - Me rastin e shënimit të 21-vjetorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Drenasit, është mbajtur një seancë solemne dhe janë bërë homazhe në të gjitha varrezat e dëshmorëve.

Fillimisht në Sallën e Kulturës është mbajtur seanca solemne, ku kanë marrë pjesë nënkryetari i Komunës së Drenasit, Nazmi Hasi, kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj, anëtarë të Kuvendit dhe drejtorë të drejtorive komunale. Seanca është udhëhequr nga kryesuesi Halilaj, i cili ka thënë 14 Qershori është një datë historike, e cila na kujton shpresën

për jetë e liri të kërkuar me shekuj.

Ndërsa nënkryetari Hasi, në fjalimin e tij në seancën solemne, ka thënë se Dita e Çlirimit është data ku me nderim të thellë kujtojnë gjithë sakrificën e jashtëzakonshme të qytetarëve të Drenasit, heronjtë, dëshmorët dhe martirët e lirisë.

“Sot kujtojmë heroizmin e familjes Jashari, luftën e shenjtë çlirimtare të komandantit legjendar Adem Jashari e bashkëluftëtarëve të tij, kujtojmë masakrat mbi civilët në Qirez e Likoshan, Abri, Izbicë, Rezallë, Reçak, Studime, Dubravë, Krushë e Madhe, Has



e masakra të tjera mbi popullin e pafajshëm e liridashës shqiptar”, ka thënë Hasi.

Pas përfundimit të seancës

solemne, nënkryetari Nazmi Hasi, kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj, anëtarë të Kuvendit dhe drejtorë të drej-

torive komunale, kanë bërë homazhe në sheshin “Fehmi Lladrovci” pranë shtatoreve të heronjve, Fehmi e Xhevë Lladrovci, Shaban, Hamëz e Adem Jashari, Rasim Kiqina, Bedri Shala, Ilaz Kodra. Po ashtu, ata kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve në Marinë si dhe në varrezat e dëshmorëve në Gllanasellë, Likoshan, Çikatovë e Vjetër, Baicë, Abri, Tërdec, Gllobar, Tërstenik, Vërboc, Shtuticë, Negroc, Krajkovë, Damanek, Shtrubullova, Poklek i Vjetër dhe Nekoc.

Gjini: 14 Qershori mbetet një prej ditëve më të rëndësishme për Gjakovën

GJAKOVË, 14 QERSHOR (ER) - Me rastin e 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Gjakovës, kryetari i komunës, Ardian Gjini, të dielën ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora me lule te varrezat e martirëve dhe dëshmorëve të komunës së Gjakovës.

Fillimisht nderime janë bërë te lapidari “Shokët e Lirisë”, për të vazhduar më tej te varrezat e dëshmorëve në varrezat e qytetit, në Kompleksin Memorial në Meje, në varrezat e martirëve në kodrën e Çabratit dhe te shtatorja e heroit Agron Rama.

Duke kujtuar kontributin dhe sakrificën e madhe që populli ynë e ka dhënë për këtë ditë, kryetari Gjini ka thënë se 14 Qershori mbetet një prej ditëve më të gëzuara dhe më të rëndësishme për Gjakovën, prandaj për këtë respekti dhe nderi duhet t’u kushtohet pikërisht të gjithë atyre që e mundësuan një ditë të tillë. Ndryshe, për nder të ditës së çlirimit, Komuna e



Gjakovës qysh herët ka planifikuar organizimin e shumë aktiviteteve ceremoniale, kulturore e artistike, por për shkak të

situatës së krijuar si pasojë e pandemisë, të gjitha këto aktivitete janë anuluar në mënyrë të pavullnetshme.

Kryetari Ahmeti nderon dëshmorët

LIPJAN, 14 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, i shoqëruar me bashkëpunëtorë, të dielën kanë bërë homazhe pranë shtatores së komandantit legjendar Adem

Jashari, në sheshin e qytetit të Lipjanit, si dhe pranë shtatores së heroit të kombit Ismet Asllani në parkun e qytetit, me rastin e 14 qershorit, ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit.



Haziri ndan mirënjohje për mjekët e pensionuar, i cilëson si gjeneratë e artë

GJILAN, 14 QERSHOR (ER) - Komuna e Gjilanit ka organizuar të dielën ndarjen e mirënjohjeve për sektorin e shëndetësisë, konkretisht për doktorët të cilët tashmë kanë dalë në pension pas një shërbimi të gjatë si mantelbardhë në kujdesin për shëndetin e popullatës ndër vite.

Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka thënë se organizimi i sotëm është më tepër ceremonial për shkak të pandemisë dhe po bëhet në këtë mënyrë. “Ju keni shërbyer në një kohë shumë të vështirë për shkak të sistemit të paraluftës që e kemi përjetuar. Jeni përballur me raste dhe çaste

shumë të vështira, edhe atë të helmimit të nxënësve. Po e them pa modesti që mjeku nuk pensionohet kurrë, sepse ai në vazhdimësi jep dije dhe shërbim për shëndetin publik. Angazhimi dhe puna juaj në kohën sa keni shërbyer dhe rrethanat në të cilat keni punuar u jep pa dyshim epitetin e një gjenerate të artë. Sot në kujtojmë gjithashtu ish-kolegun tuaj tashmë të ndjerë, Rexhep Sejfiu, i cili nuk është në mesin tonë”, ka thënë ai në fjalën e tij.

Po ashtu, ka theksuar se ky vit i kushtohet veprimtarisë kombëtare, organizative dhe rezis-



tencës për liri të Abdullah Tahir, me të cilin ishin në

aktivitete dhe njëkohësisht edhe të burgosur.

Xhavit Hajdari, në emër të të gjithëve, ka falënderuar kryetarin Haziri për këtë vlerësim duke e ndarë së bashku momentin e vështirë të vitit 1952, atë të përballjes së variolës së verës e cila ishte një vështirësi e madhe e përballjes shëndetësore.

Mjekët të cilët janë nderuar me mirënjohje: Januz Canaj Ramadan Maliqi, Shaban Rexhepi, Ismail Aliu, Ramush Osmani, Rrahman Hajdari, Xhavit Hajdari, Zijadin Hasani, Metush Aliu, Elez Elezi, Safete Palaj, Sabit Spahiu, Shefqet Mehmeti, Hazir Haziri, Xhevat Demiri.

Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (6)

RIFATI, HAMZA DHE ADEMI

**Bedri ISLAMI**

Rifat është vëllai i tyre i madh. Nuk jeton në Kosovë. Prej vitesh është detyruar të jetë larg familjes. Banon në qytetin e Munihut dhe kujdeset që familjes së tij të mos i mungojë asgjë. Ata e duan, e dinë se në trugun e tyre familjar ai është vazhdimi i familjes dhe i fisit, por edhe kanë mbështetur shpatullat tek ai. I kanë mbështetur si në një shkëmb të sigurt. E dinë fare mirë se është i njëjti brumë lufte, rrethanat e kanë shtyrë larg vendlindjes, por nuk ia kanë bjerrë tiparet. Për të shkuar deri në shtëpi i duhet t'i kalojë tre shtete. I kishte thënë dikur i ati i tij, Shabani, se "qysh po shkon aq larg, a e di se duhet tri shtete me i kaluar për me mbërri atje?", por nuk kishte pasur rrugë tjetër. Rifati është diçka në mes të Ademit dhe Hamzës, ai është pikëbashkimi i tyre. Është më i qetë, ka vështrimin e ngulitur të Jasharëve, fjalët i ka të avashhta, dashamirëse. Askush nuk ndihet i larguar prej tij. I larguar nga shtëpia, por i lidhur me të. I mërguar, por më rrënjëzim në vendin e tij. Rrugëtimet e tij kalojnë nëpër tri faza: legal, gjysmë legal, herë pas here krejtësisht ilegal. Është pjesë e familjes dhe e bën detyrën e tij. Është, si të thuash, zëri i vëllezërve në mërgim, por jo vetëm kaq, është më tepër, është pjesë e asaj që ndodh në Kosovë. Është magjia nga ku fillon e gatuhet lufta, pasi shumica e mjeteve luftarake kanë në themel djersën e tij. Bart materiale ilegale nga perëndimi në Kosovë, dhe kur vjen koha, atëherë kur duhet, shtyn më tej urët e rezistencës. Troket në disa dyer për të gjetur mbështetje, ndonjëra i hapet, por është e vaktë, ndonjëra i hapet përgjysmë, ndonjëra, ajo që ka më shumë, nuk i hapet fare. Atëherë hap kat më kat portat e tij, gjen mbështetje tek Fehmi Lladrovci më shumë se tek kushdo tjetër, dhe nuk thotë kurrë se ishte ai. Qëndron në heshtje, për shumë e shumë vite qëndron kështu, deri sa gjërat bëhen të ditura nga të tjerët. Kur rri me të, njeriu e ndjen se po rri më mirë se me vetveten. Ndoshta kjo është një dukuri e Familjes, por e rëndësishmja është se ndjehesh i sigurt, i qetë, e di se në fund të fundit, e gjithë ajo që ka ndodhur, ka ecur edhe përmes këtij njeriu të urtë. Është një treshe vëllezërisht që bëjnë një plotësi të jashtëzakonshme. Në dhjetorin e vitit 1991 kthehet

për pushime në familjen e tij. Do të jetë hera e fundit që do të udhëtojë legalisht, deri në qershorin e vitit 1999. Në shtëpi janë tre vëllezërit, prindërit, familjet e tyre. Do të jetë ndër çastet e fundit që do të jenë legalisht të gjithë së bashku. Kishte pak kohë që Ademi ishte kthyer nga stërvitjet ushtarake në Shqipëri. Ndërkohë në Kosovë kishin filluar arrestimet. Shumica e atyre që ishin stërvitur në një qendër stërvitore në Malin e Dajtit, ose kishin rënë në pranga, ose kishin marrë rrugën e mërgimit. Disa kishin dorëzuar armët dhe kishin qëndruar në heshtje, disa i kishin fshehur armët në mal dhe kishin pritur një kohë tjetër.

Ademi kishte thënë se "armët nuk i kishte marrë as për t'i fshehur në mal, as për të ja dorëzuar Serbisë, por për ta luftuar atë". Kjo kishte qenë e kuptueshme për të gjithë ata që e njihnin dhe e papritur për ata që e kishin ndërtuar gjithë këtë përgatitje si një lojë. Do të ishte njëri ndër përjashtimet e rralla. Përjashtimi tjetër do të ishte ai i Zahir Pajazitit të Llapit, por ata do të ishin dy vargmale, që megjithëse e shohin nga larg njëri tjetrin dhe ia dëgjojnë ushtimën e ortekëve kah bien, nuk kanë rast të takohen me njëri tjetrin. Jasharët janë rrethuar tri herë nga forcat e stërmëdha serbe. Me to ka ndodhur si me rrethimet e Krujës.

Rrethimi i parë do të ndodhë në natën e 30 dhjetorit 1991. Është parathënia e luftës që do të vinte. Deri atëherë, në odat e burrave të Drenicës ishte diskutuar disa herë, "a po bëhet me pendë, a po bëhet me pushkë pavarësia e Kosovës". Pas 30 dhjetorit 1991, nga të parët, Jasharët, e ndanë mendjen se fjalën do e kishte pushka. E kishin ditur edhe më parë një gjë të tillë, kishin pasur një shpresë të vaktë se mund të ndodhte edhe ndryshe, kishin dashur t'u besonin atyre që po quheshin institucione, mirëpo 30 dhjetori do të tregonte se, megjithëse do të kishte njerëz që mund të tentonin të ndalnin luftën, ajo do të vinte.

Për rrethimin e parë kam shkëputur një pjesë nga rrëfimi i Rifat Jasharit. Është një rrëfim në vetën e parë, por që i përfshin të gjithë...Ajo që më ka bërë përshtypje, që ditët kur e kam dëgjuar për herë të parë këtë histori, jo nga Jasharët, por nga Ramiz Lladrovci, është hapja e rrethit të qëndresës, mënyra se si shtrihet ai, nga njëra dhomë në tjetrën brenda familjes, nga njëra kullë në tjetrën brenda Fisit, nga njëra lagje në tjetrën brenda fshatit, dhe nga njëri fshat në tjetrin brenda Drenicës. Në se do të kishte zgatur më shumë, pra në se nuk do të kishte ndodhur tërheqja e forcave serbe, mund të kishte ndodhur shtrirja nga njëra krahinë në tjetrën, brenda Kosovës. Por mund të ishte e

parakohshme dhe njëkohësisht fatale. Lisat kanë kohën e vet. Në rrethimin që do i bëhej Tahir Mehës dhe babait të tij, 10 vite më parë, po në Drenicë, lëvizja rrethore do të jetë pak ose fare pak e dukshme. Ndoshta edhe nga fakti se rrethuesit, krahas policëve serbë, ishin edhe shqiptarë. Jasharët do të jenë ndër ato që do të lëvizin në krah të Mehajve, por kjo nuk do të ishte e mjaftueshme. Në 30 dhjetor 1991 ndodh diçka krejt tjetër, ndodh një lëvizje që ka një përhapje jashtëzakonisht të shpejtë, mali vjen e mbushet me njerëz të armatosur, nuk dihet më se kush është prekazali e kush është drenicak, kush është mik e farefisni, e kush është i panjohur.

frikën fare atyre, por nuk doja të na zënë në gjumë. Nuk po vijnë jo "këmbëngulte Ademi", ndërsa unë këmbëngulja në timen: "Pasha Zotin, veç sa nuk po i shoh rreth oborrit". "Hajt shko fli e mos u bëj merak", ma ktheu Ademi, dhe më urdhëroi që të shkoja për të fjetur. U përshëndetëm dhe shkova të fle. Sa më kishte zënë gjumi, Ademi trokiti ngadalë në derë, duke më thënë: Çou Rifat se u rrethoam...". Unë mendoja se ai kishte diktuar diku larg policinë serbe se ishte duke ardhur në Prekaz dhe nuk nxitova fare, ndërsa ai më tha se po shkonte t'i bënte zë babës. Dy herë ka shkuar tek plaku dhe është kthyer kah unë, duke më

revole dhe automatikun. E bëja me mend, nëse arrij t'i shkrep të gjitha këto, puna nuk do të ishte keq.

Pasi i zbrapsi policës që donin të futeshin në oborr andej nga kulla, Ademi u kthye te unë dhe më pyeti:

- A të mori ndokund?

- Jo, i thashë dhe e pyeta se mos e kishte kapur ndonjë plumb atë?

- Këtu më është nxehur pak, tha ai, duke treguar kah brezi.


Kur ia hoqa këmishën, nuk kishte pasur gjë serioze, ndërsa në ato momente, në rrugë u ndez automjeti i ndihmës së shpejtë. E paska hëngër dikush prej tyre, i thashë Ademiti.

U ngjita në kullë dhe përmes dritareve të saj i vëreja policët, të cilët iu kishin veshur muret poshtë, por nuk guxonin të bëjnë hapa e të provojnë të futen në oborr. Biseduam shpejt e shpejt me Ademin dhe vendosëm të depërtojmë në anën e kundërt, andej nga lagjia e Lushtakëve...

...Ishte një pjesë nga rrëfimi i Rifat Jasharit. Ishte 30 dhjetor i vitit 1991. Fund viti dhe fillim lufte. Do të jetë hera e fundit që luftojnë së bashku. Nuk do të kenë rast tjetër, megjithëse lufta i kishte trokitur herët në portat e kullave të tyre. Prej kësaj date edhe ai do të jetë ilegal në shtëpinë e tij, herë pas here do të kthehet aty nëpër natë, i shoqëruar nga miqtë dhe shokët, shumë prej tyre ilegalë, si ai. Do të kthehet gjithnjë me ndjenjën e mallit, fillon e ndjen mbi vete peshën e mos qenies së tij së bashku me vëllezërit, mendon të mos kthehet më, në atë vend të huaj, pas më shumë se tre shtetesh tashmë, Bisedon me vëllezërit. Mendjen dhe shpirtin e ka tek shtëpia dhe njerëzit e tij. E di krejt mirë se tash ka ardhë një kohë tjetër, se asgjë nuk do të jetë si më parë, se dy vëllezërit e tij e duan edhe një krah më shumë, mirëpo fjala e tyre është e paktë dhe e saktë, "A e bën mend se 30 anëtarët e tjerë të familjes duhet të mbahen".

Është kohë e vështirë. Vëllezërit do ta duan përherë ndihmën e tij, ai do e ndjejë përherë mungesën e tyre. Është një kohë që përmes telefonit shtohet malli, shtohen pikëpyetjet, ai nuk e di më se ku kanë bujtur vëllezërit e tij, tashmë ilegalë, që nga 30 dhjetori 1991 dhe deri në ditën e 7 marsit 1998, cila është vatra që i ka dhënë zjarr, konaku ku kanë rënë, por e di krejt mirë se cilido të jetë ai, është për të mirë.

Do i kujtohet shpesh, se pas natës së 30 dhjetorit, u hapën për to dhjetëra e dhjetëra shtëpi. Vëllezërit e tij u strehuan tek Shaban Shala, në Negrovci. Afër Shaban Shalës është një familje, ajo e Krasniqëve. Dy vëllezër janë aty. Ajeti dhe Shefqeti. Nana e tyre, me sa i kujtohej, e kishte emrin Hanë. Një plakë e dashur, që i ngjante shumë nanës së tyre. Djemve të Prekazit u lëshon dhomën e nuses. (Vijon)



RRËFIMI I RIFAT JASHARIT PËR NATËN E 30 DHJETORIT

... Arrestimet së pari fillojnë në Deçan, në disa lagje e fshatra të kësaj komune... për t'u zgjeruar pastaj edhe në rajonin e Prishtinës, atë të Klinës etj. Erdhën dy djem të Klinës së Poshtme dhe e kërkuan Ademin. Ishte 30 dhjetor. Ata ishin të përfshirë në organizim. Filluan të më tregojnë se policia kishte tentuar t'i arrestonte. Ata kishin ardhur të kontaktonin me Ademin për të ditur se çfarë duhet bërë më tutje. Kur erdhi Ademi, i tregova për këtë dhe ai me shokë u tubuan shpejt në kullën tonë. Pastaj biseduam me babën Shaban, me Ademin e me Hamzën se çka të bëjmë më tutje. Vetëm për sekonda bëhet fjalë deri sa policia serbe të vijë tek ne, u thashë unë, ndërsa Ademi, duke qeshur më tha: Jo, nuk vijnë, nesër është Viti i Ri, ditë tregu dhe pretojnë me ardhë". More, i thashë, veç momenti pritet. "Ku po mërzhitesh për këtë punë", më tha Hamza. Unë e kisha një parandjenjë dhe më dukej se veç po i shihja të rreshtuar policët serbë. U thashë se nuk ua kisha

thënë "çou më, çka po bën". I kam thënë hajt se deri sa të vijnë ata, unë bëhem gati, ndërsa Ademi ma ktheu shkurt: "Te trafoja në rrugë janë".

Është zgjuar edhe Hamza, dhe më tha, "gati jemi". Ndërsa unë vesh një pallto dhe mora një palë këpucë të këqija në këmbë dhe për disa sekonda kemi nxituar që t'i marrim pozicionet.

Dolëm kah ana e epërme e oborrit dhe e ndezëm luftën me ta. Hamza ishte në një pozicion afër një dardhe në oborr, unë kisha zënë një pozicion në skaj të oborrit, pikërisht aty ku me 6 mars 1998 ka rënë Fitimi, duke luftuar me mitraloz, ndërsa Ademi kishte zënë një pozicion tjetër. I thashë: "O djalo, vepro me shumë mend se mos janë futur në brendi të oborrit te kulla", ndërsa Ademi më tha: "Veç mos e lësho frontin aty". Kur Ademi iu afrua kullës për t'ua zënë aty pritën policëve që të mos depërtojnë brenda, ata kishin qenë duke hyrë në oborr. Menjëherë ka hapur zjarr mbi ta, duke i sharë në atë serbishten që e dinte fare pak: "Kur po shkoni he nanën e çetnikëve ua..." u ka bërtitur atyre dhe për nja 4-5 minuta aty i ka shkuar flakë e verdhë.

Unë e kam ndërruar pozicionin dhe kam dalë më poshtë, ndërsa me vete i kisha disa bomba, një

Shumë shtete evropiane hapin kufijtë, por jo me ShBA-në dhe Azinë

BRUKSEL, 14 QERSHOR - Evropa është duke marrë një hap të madh drejt normalitetit, derisa shumë shtete evropiane po i hapin kufijtë tre muaj pas izolimit si pasojë e Covid-19. Por, turistët nga Shtetet e Bashkuara, Azia, Amerika Latine duhet të presin ende. Shtetet të cilat mund të udhëtojnë nga BE-ja dhe nëpër bllok janë ato të zonës së

Shengenit. Por, shtetet e mediteranit si Greqia, e cila pret një numër të madh turistësh çdo vjet, janë të brengosura nëse mund të shpallen si destinacione të sigurta për shkak të rasteve aktive.

Greqia deri tash ka pasur 183 viktima nga koronavirusi, ndërkaq Evropa ka shënuar 182 000 viktima si pasojë e virusit. Spanja, që pritet të fillojë tur-

izmin nga 1 korriku, ka lejuar mijëra gjermanë që të vizitojnë ishujt Balearik si provë dyjavore duke filluar nga e hëna.

Disa shtete kanë hapur edhe kufijtë tokësorë. Italia e ka filluar këtë proces më 3 qershor, ndërsa Polonia e ka hapur kufirin të shtunën.

Austria do t'i rihapë kufijtë të martën, përveç me Spanjën, Portugalinë dhe Britaninë.



Polonia 'pushton' gabimisht Çekinë



VARSHAVË, 14 QERSHOR - Polonia e ka pranuar se ka pushtuar gabimisht për pak kohë Republikën Çeke muajin e kaluar, një incident ky të cilin ministria polake e mbrojtjes e përshkroi si "keqkuptim". Trupat polake, që kishin shtuar patrullimet në kufi si pjesë e masave kundër koronavirusit, kishin zënë pozicion në një kishë të vogël, e cila, në fakt, ndodhej në anën çeke të kufirit. Ata kanë

qëndruar atje për disa ditë. Ushtarët polakë i kanë ndaluar vizitorët çekë që të hynin në kishë dhe në fund autoritetet çekë vendosën të reagojnë duke kontaktuar me Varshavën. Incidenti ndodhi në Moravi, në verilindje, në një zonë që formon pjesë të rajonit historik të Silezisë, pjesa e të cilit shtrihet edhe në Republikën Çeke.

Polonia e përshkroi incidentin si "gabim", por Ministria e

Jashtme e Çekisë tha se ende po pret një shpjegim zyrtar për ngjarjen. Kisha ndodhet rreth 30 metra brenda territorit çek. Sipas shtypit vendas, arsytet përse ushtarët polakë vendosën ta bëjnë këtë inkursion të shkurtër, nuk dihet ende, ndërsa nuk është sqaruar sesa zgjati saktësisht kjo aventurë. Por ana polake pretendon se ishte një keqkuptim i cili është sqaruar tashmë.

Motra e Kim Jong-un kërcënon Korenë e Jugut me veprim ushtarak



SEUL, 14 QERSHOR - Motra e liderit suprem të Koresë së Veriut, Kim Jong, Unka, kërcënuar me veprim ushtarak kundër Koresë së Jugut teksa kritikonte Seulën për përkeqësimin e marrëdhënieve bilaterale dhe paaftësinë për t'i ndaluar aktivistët që

shfaqin parulla kundër Penianit në kufirin mes vendeve.

Duke e përshkruar Korenë e Jugut si "armik", Kim Yo-Jong përsëriti kërcënimet e mëherëshme duke thënë se Seuli së shpejti do ta dëshmojë shembjen e zyrës "së padobishme" të

marrëdhënieve ndërkoreane në qytetin kufitar Kaesong. Znj. Kim, e cila mban postin e zëvendës drejtoreshës së parë të komitetit qendror të Partisë Komuniste, tha se hapin e ardhshëm të kundërpërgjigjes ndaj Seulit do t'ua linte në dorë krerëve ushtarakë.


Turqia zbulon ilaçin kundër Covid-19, e porosit edhe Rusia

ANKARA, 14 QERSHOR - Shkencëtarët turq kanë prodhuar ilaçin e parë të sintetizuar, prodhim vendor që do të përdoret kundër Covid-19, ka thënë të dielën ministri turk i Teknologjisë dhe Industrisë, Mustafa Varank. "Është një burim i lumturisë dhe krenarisë që ilaçi ka arritur në fazën e licencimit", ka deklaruar Varank në një deklaratë me shkrim. Ilaçi i sintetizuar në Turqi, i quajtur "Favipiravir", i cili përdoret për trajtimin e Covid-19, është zhvilluar në bashkëpunim mes Ministrisë së Teknologjisë dhe Industrisë, Ministrisë së

Shëndetësisë, Këshillit të Hulumtimeve Shkencore dhe Teknologjike të Turqisë (TUBITAK), Universitetit Medipol në Stamboll dhe kompanisë farmaceutike "Atabay Ilaç".

Ekipi prej 32 shkencëtarësh ka zhvilluar ilaçin duke e sintetizuar atë me një lëndë të parë vendase në vetëm 40 ditë.

Ilaçi i sintetizuar "Favipiravir" është një nga projektet e lansuara në kuadër të platformës së Turqisë Covid-19, ku janë zhvilluar punime hulumtuese dhe zhvillimore në lidhje me zhvillimin e ilaçeve dhe vaksinave.



Brazili tejkalon Britaninë për nga numri i viktimave nga Covid-19

Brazilia, 14 qershor - Numri i viktimave në Brazil si pasojë e Covid-19 ka arritur në 41 828, duke tejkaluar Britaninë të premten. Brazili, sipas statistikave,

është shteti i dytë me numrin më të madh të viktimave në botë.

Sistemi shëndetësor i Brazilit po përballet me shifrat më të rënda të të

infektuarve nga Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka raportuar të premten 828 810 raste, 25 982 të reja brenda 24 orëve dhe 909 viktima.

Ministria e Shëndetësisë ka raportuar më shumë se 1 200 viktima në ditë që nga dita e martë, në kohën kur vendi po tenton t'i relaksojë masat dhe të rihapë bizneset.





Anna Akhmatova – Fati personal dhe qytetar i poetes... edhe në përtejvarr

Nga Agron TUFA

Poezia qëndron në shtratin e temës, së skicuar më së qarti në poezinë e vitit 1922 “Të shumtëve”. (Shih gjithashtu: “Por unë po ju paralajmëroj”, 1940; “Ashtu siç jam. Paç fat me një tjetër”, 1942; “Kujt dhe kur i kam thënë”, 1952; “Përnën cilat rrënoja po flas”, 1959.) Megjithëse “ju”, këtu kuptohet si rrethi i bashkëkohësve (lexuesve apo njerëzve në përgjithësi, të cilët në një mënyrë a në një tjetër u përfshinë në rrethanat e jetës së autores), të ndarë nga poetja, megjithëse jo krejt shpërfillës ndaj fatit të saj. Aspak “llumra”, po më saktë, janë ata të cilët mund t’i quash ende të ndjeshëm, përvujtnarë, solidarë, simpatizues, por që asnjëri nuk ka kurajën ta bashkëshoqërojë poeten në rrugën e saj, të hedhë hapin e fundit të bashkimit me të (“Vërtet do ta pini gotën që unë pi dhe do të pagëzoheni me atë pagëzim me të cilin unë pagëzohem. Por të vë ndokënd të më rrijë në të djathtën ose në të majtën time – kjo nuk është në pushtetin tim ta jap – kjo gjë u përket atyre për të cilët është bërë gati”... Ungjilli sipas Markut, X, 39-40, sipas përkthimit të Dom Simon Filipajt, “Drita”, Ferizaj, 1994).

Përpos kësaj, në poezi vihen re motivet danteske që janë karakteristike për të në periudhën e kalimit të saj nga faza e hershme e interpretimit në të vonën, pra përqendrimi në fatin personal dhe qytetar të poetes, i cili do ta ndjekë atë dhe në botën e përtejvarrit.



Kthimi kah Dantja e ka bashkëshoqëruar krijimtarinë e Akhmatovës, si rregull, me temën e syrgjynit/ dëbimit dhe shënjohej me metafora të tilla: “këmisha e pendimit”, “qiriri” dhe “buka e hidhur”, që përsëritet në shumë poezi të saj, duke nisur nga “Nuk jam unë nga ata që braktisin vendin” (1922) e duke mbaruar me “Trashëgimtares” (1959). Mirëpo, nga fillimi i viteve ’60 dominues bëhet “vendi i rathëve danteskë” (kryesisht

në “Prologun” dhe në “Radhinjtë e mesnatës”). Kjo poezi shënon qasjen e parë të saj te periudha danteske: “në satërin e zi” (krahaso me vargjet e vitit 1935 “Përse ju i helmuat ujërat”: “...Pa një xhelat e një staër/ nuk mund të ketë poet mbi dhe./ Me një këmishë pendimi veshur,/ me një qiri – ec e l’sho kujë”), sikundërse dhe vargjet e kësaj poezie: “Duke u sjellë në hon të zi,/ Në mort të mbramë, a në parajsë.”

Ndoshta shenjë më bindëse e shfaqjes së ngjashmërisë në këto poezi të Akhmatovës, – që i shëmbëlajnë frymës danteske – është patosi i përgjithshëm i tonit, më shumë sesa ballafaqimi skrupuloz me citate. Kryqëzimi citator dhe përshkrimor ndërmjet vargjeve e poezive është aq i shpeshtë, sa këtë gjë e kanë vërejtur me kohë akhmatologët. Por, me sa di unë, në rrethin e përkimeve tekstuale që sjellin rëndom deri më sot nuk janë ndeshur vargjet “Pse pra, ju, lirinë e mbrame/ Po e shndërroni në një shpellë?” – nga poezia që përmendëm “Përse ju e helmuat ujërat”. Shpellë (Bepren) –

“strehë e cubave, kriminelëve dhe përdhosësve” sipas fjalorit bashkëkohor – do të thotë edhe bordello, në të cilën po shndërronëj gjithë Rusia sovjetë, në analogji me kujën demaskuese të Dantes për Italinë (“Purgatori”, vargjet VI, 78). Patetika e lartë, në mënyrën e vet, një trimërim i zëshëm i të gjithë fragmentit përgjatë 76 vargjeve, kumbon me po atë tendosje në një radhë poezish të afërta në frymë të Akhmatovës, sidomos në këtë që po publikojmë këtu. Kjo bën diferencën e poetëve, të cilët ne kemi arsye t’i quajmë “të mëdhenj”, në raport me të tjerët. /Exlibris.al

Anna AKHMATOVA (1889-1966)

Të çmendur! As vetë s’e di,
Nuk e di se ku po shkoj –
Duke u sjellë në hon të zi,
Në mort të mbramë, a në parajsë
Po ju tërheq me vete pas.
Vaj, se ç’krenari mizore
Na lidhi si armik symprehtë,
Më ngjeth kjo qëndresë që prore
Në besë betimesh digjet vetë.
Se ku ju shpura pa e ditur,
Mezi do t’ju bjerë në hatër –
Në cilin vend jeni gostitur,
Si në një qilar t’muosur
Në orë të ligë me kokë në satër.
Papo se ç’turp me mua ndatë
Me heshtjen time vitesh struktur...
Do të rroni, jeni... ishit, patë...
Ndërsa unë – ylli i këputur.
Moskë, 10 tetor 1959 (ditën)

E rrallë

Kthen librin në bibliotekë pas 39 vjetësh

Një libër biblioteke, që një lexuesi i pëlqeu aq shumë sa e ktheu pas 39 vjetësh, 13 javësh dhe pesë ditësh pas afatit, tashmë është përsëri në vendin që i takon. "Lexuesi duhet ta ketë pasur të vështirë ta dorëzonte librin", ka shkruar në "Twitter" një bibliotekar në qytetin jugor Groesbeek. Gjoha për kthimin e librit



me vonesë duhet të jetë rreth 1 530 euro, sipas përlogaritjeve të agjencisë holandeze të lajmeve, ANP.

FOTO E DITES




Një pjesë e lumit afër Bundestagut ka marrë ngjyrë të gjelbër pasi disa aktivistë të një organizate "Rebelimi i zhdukjes" me këtë veprim kanë kundërshtuar politikat e qeverisë rreth qymyrit. /AFP/

E jashtëzakonshme

Zhdukja e bletëve do ta silte fundin e jetës në tokë

Instituti 'Earthwatch' së bashku me shoqërinë mbretërore gjeografike të Londrës, pas një analize të detajuar, kanë dalë në konkluzionin se krijesa e vetme që nuk duhet të zhduket, dhe që rëndësia e saj është bazike dhe jetësore për planetin tokë, është bleta. Ata deklaruan se bletët janë krijesa më e rëndësishme



e planetit tokë dhe se pa to ekosistemi ynë do të shkatërrohej, duke e bërë të pamundur jetesën në tokë. I frikshëm është fakti se tashmë bletët kanë hyrë në listën e kafshëve që rrezikojnë zhdukjen dhe në krahasim me disa vite më parë, numri i tyre ka rënë me 90 për qind në aspektin global.

BARSOLETA E DITËS

I biri me të atin ishin ulur për të ngrënë supë për drekë. I biri e provon i pari supën, por ajo ishte aq e nxehtë sa atij nisën t'i rridhnin lot nga sytë.
I ati e pyet: - Përse qan, o bir?
I biri i fsheh të vërtetën duke iu përgjigjur: - Mu kujtua nëna e vdekur!
Atëherë i ati hesht dhe fut edhe ai në gojë një lugë supë.
Supa tepër e nxehtë e bën edhe atë t'i dalin lot nga sytë.
- Pse po qan o babë? - e pyet i biri tinëzar.
- Mu kujtua jot ëmë se çfarë kopili ka lënë, i tha i ati.


KINO ABC PRISTINE

Në Kino ABC nuk ka shfaqje

Sulltan Mehmeti II për Gjergj Kastriotin: Kurrë s'ka për të dalë më mbi tokë një luan i tillë

Të gjithë e dimë historinë e heroit tonë kombëtar, ngjarjet e këtij heroi që lanë gjurmë të mëdha në historinë shqiptare dhe jo vetëm. Gjergj Kastrioti Skënderbeu shumë shpejt u shndërrua në makthin më të tmerrshëm të

Perandorisë Osmane. Më poshtë, KultPlus ju sjell një thënie që Sulltan Mehmeti II e kishte thënë për Gjergj Kastriotin Skënderbeu në vitin 1467: 'Kurrë s'ka për të dalë më mbi tokë një luan i tillë'.



 <p>DASHI Kjo ditë sot do të jetë e mirë për ju. Do të jeni në humor dhe do të realizoni disa vizita te të afërmit dhe te shoqëria.</p>	 <p>DEMI Nëse e ndieni veten krijues, merruni me një piano, kitarë, vizatime etj. Aftësitë tuaja shprehëse janë në kulmin e tyre.</p>	 <p>BINJAKËT Dita e sotme gjithçka duket se do të lëvizë dhe do të sjellë lajme të mira. Yjet do t'ju bëjnë të ndieni një forcë të madhe.</p>	 <p>GAFORRJA Sot gjendja juaj shpirtërore do të bjerë shumë poshtë. Merrni të gjitha informacionet e nevojshme para se të veproni për çdo çështje.</p>	 <p>LUANI Ju mund të realizoni një ëndërr që keni pasur prej kohësh dhe të vizitoni një vend ose një ekspozitë që ka zhvilluar imagjinatën tuaj.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Nëse vazhdoni të mendoni për ditët e mëparshme, mund të përballeni me një situatë jo fort të këndshme.</p>
 <p>PESHORJA Ju jeni të ndjeshëm ndaj çdo nuance të atmosferës përreth jush: varianti më i pakuptueshëm i gjendjes shpirtërore të partnerit ju hedh në ankthin më të errët dhe ankthin më të egër.</p>	 <p>AKREPI Njerëzit që keni përreth do ta tregojnë dashurinë që kanë për ju, duke bërë diçka më shumë se zakonisht. Merrni pak kohë vetëm për veten tuaj.</p>	 <p>SHIGJETARI Zgjidhja e disa problemeve të vogla që ju shqetësojnë do të bëhen në mënyrë shumë paqësore. Sot hëna do t'ju bëjë më të zgjuar, tërheqës dhe intuitiv.</p>	 <p>BRICJAPI Mbani pranë persona që mund t'ju ndihmojnë në sfidat që mund të përballeni dhe jo persona që e kanë mendjen vetëm tek argëtimi.</p>	 <p>UJORI Këtë të diel ju mund të përjetoni kënaqësi maksimale në fushën sociale dhe relacionale.</p>	 <p>PESHQIT Kjo është koha e duhur për të shkuar me pushime, për të marrë vendime, për të planifikuar disa shpenzime dhe për të kaluar në një rutinë më të shëndetshme.</p>

Xhensila Myrtezaj vendoset në Prishtinë, çfarë po përgatit këngëtarja?



Me anë të një postimi në "Instastory", këngëtarja Xhensila Myrtezaj ka treguar se ndodhet në Prishtinë për projektin e ardhshëm muzikor. Ajo ka ndarë një moment nga studio e DJ të njohur,

Mixey, me të cilin kanë bashkëpunuar shumë emra të njohur, ndër ta edhe Nora Istrefi. Nga e njëjta studio ka publikuar një foto edhe Bes Kallaku, duke ngjallur shumë dyshime te fansat.

Irina Shayk merr gjithë vëmendjen me foton e fundit në "Instagram"



Irina Shayk është një modele ruse me famë botërore. Irina me linjat e saj seksi dhe me bukurinë që ka, bëri që të jetë një ndër modellet më të kërkuara në fushën e modës. Ajo madje

shpeshherë është cilësuar si "ikonë e bukurisë". Së fundmi ajo përsëri ka marrë vëmendjen e medieve rozë me foton e fundit që ka publikuar, ku shfaqet me një bluzë jeshile, e shtrirë në dysheme.



Dua Lipa, ndryshim drastik në pamje, lyen flokët kuq e zi

Dua Lipa bën një ndryshim drastik në pamjen e saj gjatë muajve sa ishte në izolim. Prej disa kohësh është vënë re se këngëtarja e njohur, Dua Lipa, ka


vendosur të bëjë eksperimente me "look"-un e saj. Ajo ka ndryshuar disa herë ngjyrën e flokëve dhe së fundmi ka vendosur t'i lyejë ato në ngjyrë të kuqe dhe të zezë.

Familja Obama blen shtëpi të re



Ish-presidenti Barack Obama dhe zonja e tij Michelle Obama kanë blerë një shtëpi me shtatë dhoma gjumi, në Masaçuset, dhe çmimi i paguar për këtë pronë prej 29 hektarësh ishte 11.75 milionë dollarë, tregojnë të dhënat publike. Shtëpia

kushtoi 3 milionë dollarë më pak se çmimi fillestar për pronën prej 7 000 metrash katrorë. Obama ka vite që është aktiv në këtë zonë, por ata nuk janë të vetmit politikanë që adhurojnë zonën bregdetare të Anglisë së Re.



“Përpara Fundit” në përgjigjen e fundit

Recension intim për librin e Ernesto Sabatos

Nga Zija ÇELA

I dashtun Ernesto!

Letrën tuaj e mora dhe më duhet t'ju them se arriti kur nuk e prisja më. E kam fjalën për librin tuaj “Përpara Fundit”, që i përkthyer në shqipe u botua edhe këtu. Sigurisht, e fshehta që më besuat dikur në Tiranë (“Po shkruaj një libër për Kozmosin!”) më pati shtyrë të mendoja për hapësira të llojit tjetër, si i thonë fjalës, të parrokshme. Por edhe në një pikë loti, prapëseprapë, e gjeta grimcën kozmike.

Ah, syri juaj, dhembja juaj! Syri që pikon e dhembja që fërgëllon nëpër fletë.

Nuk është çudi që pikërisht rruaza e lotit të jetë Alefi i parë, ai i vërteti, të cilin ne më kot e kërkojmë ndryshe duke fantazuar sipas Borgesit. Pylli i errët i vetmisë që ju mundon, ishte aq tronditës, sa më gllabëroi menjëherë dhe ndonëse me vonesë, marr pjesë në zinë tuaj pikëlluese. Ju thoni se biri juaj Jorge Federiko vdiq dhe se për ju gjithçka është shembur, duke jua ndalur kohën. Ju thoni që, i dehur nga dhembja, mes rrënojave të mendjes, ju kumbojnë

përvëlueshëm vargjet e Vallejos se ka kaq goditje të forta në jetë, goditje si urretja e Zotit!

Ju falem Mjeshtë, por askush nuk e vë në dyshim se ju keni gjithashtu dashurinë e Hyjit, pasi Providenca dhe vetëm Providenca, që ju dha atë talent suprem, e di mirë se sa shumë keni bërë për artin e sotëm.

Midis emrave të tjerë, plot emrave që u referoheni në libër, u ndala me kureshtje të veçantë tek Elvira Gonzales Fraga, menaxherja e përzemërt që pata rastin ta njihja atëherë në shoqërimin tuaj. Kam frikë se, për fat të keq, mirënjohja aq drithëruese që shprehni ndaj saj, do të gjejë veshë të shurdhët në një botë të mbushur me mosmirënjohje. Mirëpo, shkarazi, ju kujtoj se unë nuk i mallkoj mosmirënjohësit, pasi thuhet se kjo skotë është e vetëmalkuar.

Sa për pjesën që ia kushtoni ardhjes suaj në Tiranë, tablosë festive me muzika, vrojtimeve të shpejta, ndonjë përmendjeje që... Më falni, këtu po ndalem më gjatë. Ka rrjedhur mjaft ujë nga ajo ditë, i nderuar Mjeshtë, dhe për të sjellë një fakt ju nuk e dini se kam botuar novelën “Gjaku im i errët”


(2002), ku flas jo për një, por për dy takime tonat. Atë në hollin e Hotel Tiranës, të cilin e kam riprodhuar me besnikëri të rreptë, thujse fjalë për fjalë, si dhe atë të trilluarin, me Borgesin, në Bibliotekën Nacionale të Buenos Airesit dhe në shtëpinë e rrugës Garay. Ndër të tjera, te libri im do të gjeni edhe frazën: “Pompë të madhe pati kur Sabato ia mbërrini që nga Argjentina në Tiranë.” Kurse në Buenos, nisur

nga mosha dhe gjendja juaj shëndetësore, i shpreh Borgesit një dyshim, dyshimin se mbas aq vitesh prej takimit tonë të parë, ndoshta truri juaj (rrënojat e trurit, thoni ju) ka filluar të mjegullohet, andaj kujtimet ju ndërthuren dhe ju mbivendosen gabimisht. (“Është kthyer Skënderbegu në Shqipëri? Diktatura është rrëzuar, apo jo?” – më pyesni në pasticerinë Zunino & Zungri.) Zoti më vraftë, kanë qenë

parandjenja rrëshqitjet e kujtesës suaj në librin tim, apo...?!

Nuk po e zgjas, por po citoj në mënyrë integrale librin tuaj:

“U ktheva nga Shqipëria, ku mora çmimin Kadare. Isha i shkatërruar, por megjithatë mbledha forcat dhe shkova, për të mos e zhgënjyer këtë vend të varfër. Në Tiranë m'u bë një nga vlerësimet më emocionuese të jetës sime. Ai vend, që ka vuajtur mbi kurriz një tiranë, ku ende mund të shihen mbeturinat e diktaturës, fytyrat e kontraktuar nga vuajtjet dhe bunkerët e skëterrshëm, të ndërtaur me urdhër të tiranit, më priti si një bamirës, si një mbret, si një bir të dashur. Organizuan këngë e vallëzime me rastin e dhënies së çmimit. Një poet më ofroi një vazo plot me dhë të mbledhur nga toka e lindjes së sime mëje. Ndërsa një shkrimtar i madh më tregoi një fletore të mbajtur fshehurazi në burg; me shkronja të vogla kishte kopjuar një tekst të Kamysë dhe “Djalit e dashur e të hershëm”, Abandonin tim. Më tha duke qarë se gjatë viteve të shumta, që kishte rënë brenda si i burgosur politik, në errësirën e burgut lexonte çdo ditë ato



faqe, fshehurazi, për të përballuar dënimin. U trondita..." ("Përpara Fundit – Rrëfim mbi një Shekull", faqe 128, Tiranë, 2003.)


Vallë, në ç'kopshte ju kanë shëtitur dhe hamgjitur, miku im i ngratë?! Nëse nuk do ta kisha botuar librin që ju përmenda dhe nëse as ju nuk do t'i hidhnit në letër këto kujtime (scripta manent), kurrsesi nuk do t'i hyja rektifikimit. Them rektifikimit dhe jo identifikimit, pasi të dy jemi identifikuar dyfish më përpara. Në librin "Gjaku im i errët" është edhe fletorja ime me kutiza të vogla, Fletorja e Fshehtësive. Aty ndodhen të kopjuara me dorë tekste nga "La Chute" i Kamysë, nga romani juaj "L'ange des ténèbres" dhe nga vepra të autorëve të tjerë që, në kohën kur i kopjoja, i kishim të ndaluara. Ju u mahnitët duke parë se shënimet nga "L'ange des ténèbres", romani juaj që e kisha lexuar në frëngjisht e ku përfshihet edhe Abandoni, zinin 28 faqe. Ndërsa fragmentin ku tregoni origjinën shqiptare nga mëmësia ("Elle a cinquante pour cent de sang albanais") tashmë e kisha përkthyer dhe e kisha botuar (Drita, 28 qershor 1992), pa më vajtur kurrsesi në mend se do të takoheshim një ditë.

Mbasi mbaroi ceremonia e Çmimit, atë mbrëmje nuk kemi qenë bashkë. Nuk qemë bashkë, sepse unë nuk isha i ftuar për darkë. Me gjithë këmbënguljen tuaj, "ftesën personale" nga ana juaj, u tregova kokëfortë dhe nuk pranova të vija mik pas miku, bythec në fjalorin malësor. Atëherë ju kërkua që, të paktën, atë Fletore ta mbanit një natë në Hotel Tirana. Kurse të nesërmen, e diela e prillit 1996, ma kthyet në hollin e atij hoteli (ndërsa mikpritësit po hanin mëngjesin), në një takim që ka mbetur i paharueshëm për mua. Pikërisht në kapakun e brendshëm të Fletores sime, edhe sot e kësaj dite ndodhet shënimi në frëngjisht që ma kishit lënë me shkrimin tuaj të imët, duke m'u drejtuar: "Për Zijain, me një nga emocionet më të mëdha të jetës sime... etj."

E si kështu, Ernesto, i keni bërë lëshim kujtimet e atëhershme, duke më dhënë merita që nuk më takojnë dhe që nuk mund t'i mbaj?! Unë nuk kam qenë ndonjëherë i burgosur politik dhe për hir të së vërtetës, gjatë asaj gjysmë ore që kuvenduam së bashku (ndoshta kanë qenë dyzet minuta, po kush e pa sahatin!), as nuk u zu ngoje politika. Nuk folëm as për burgjet, as për tiranin e tiraninë. Si të pushtuar nga njëfarë ekstaze, ne folëm vetëm për Perëndinë dhe Tiranin tonë të përbashkët – Artin, dhe folëm sidomos për veprat tuaja.

Sido që të kishte qenë fati im, nuk do të më bënte zemra që atë kohë të pakthyeshme, e cila të jepet vetëm një herë në jetë, ta shpenzoja me dertet e mia.

Kurse për atë cilësimin që bëni... Ernesto, si ju ka ardhur në mend të më cilësoni "shkrimtar i madh", bash siç më paraqitët edhe tek Elvira?! Ju falënderoj me zemër, Maestro, por sinqerisht ju them se tek unë kalon rikoshet. Atë përshtypje (Me një mijë dreqen, hiqeni nga mendja pra!) ju mund ta keni krijuar nga rekomandimet e ndonjë dashamirësit tim, ndoshta autoritet letrar. Me gjasë, edhe nga marrëdhënia e përnjëhershme, ai komunikim e mirëkuptim i mistershëm që reflektoam gjatë takimit tonë, thua se patëm Zotin ndërmjet. Por thelbi, që më vë në siklet, është ky: Ju nuk keni lexuar asgjë timen. Unë nuk e përmbusha dëshirën tuaj që t'ju dërgoja diçka. T'ju them të drejtën, kur u botua "Te olvidas los zapatos, hombre", ngaqë ishte në spanjisht, pra në gjuhën tuaj, më shkoi nëpër mend kalimthi t'ju dërgoja me postë. Por hoqa dorë pa mëdyshje, duke i qëndruar besnik rezistencës që kisha treguar ndaj jush. A ju kujtohet çasti kur zonja Elvira këmbëngulte të merrte adresat e mia? I dua patjetër, thoshte, Maestro kërkon t'ju shkruajë. (Më përfytyrohej ndonjë mujshar, i cili prej etjes babëzisë për lavdi, nuk do të jepte një, por nja dhjetë adresa, në mënyrë që të spekulonte hatashëm pastaj me korrespondencën tuaj!) Jo, jo, e



kundërshtoja Elvirën. Dhe pikërisht prej atij ngulmimi, duke dashur ta bëja sa më bindës qëndrimin tim, u ktheva nga ju me këto fjalë:

"Mjeshtë, po unë e kam marrë me kohë letrën tuaj."

"Si kështu?" – u habitët.

Atëherë vura gishtin në Fletoren me kutiza, pikërisht te faqja "Mon cher et lointain jeune ami..." të Abaddon-it.

"Kjo është letra, Maestro. E kam gjetur në romanin tuaj dhe e kam riprodhuar me shkrim dore", – thashë. – "Letra që dikur i keni shkruar një shkrimtari të largët dhe ku gjendet e gjithë përkrahja juaj, të gjitha pikëpamjet tuaja për letërsinë e lexuesin. Jemi takuar herët bashkë, Ernesto... Përse të mundoheni tani, ju nuk mund të shkruani një letër tjetër më të bukur se kjo!"

Por e pranoj, keni arritur ta

shkruani sërish në mënyrë fort prekëse, intime dhe të thellë. Besoj e kuptoni ku e kam fjalën, te libri juaj "Përpara Fundit". Jam tërhequr pra, duke e pranuar këtë libër si një letër tjetër prej jush. Dhe ua di për nder. Ndërsa këtë letrën time, të cilën e marr në dorë herë pas here, e lehtësoj prej diçkaje dhe e plotësoj me ndonjë kujtim, nuk kam për t'ju dërguar kurrë. Ju pata thënë që të mos i kurseni sytë, madje të mos i kurseni goftë dhe po të verboheshit duke shkruar, por nuk kam dashur asnjëherë ta shpenzoni dritën për çfarë nuk është e domosdoshme.

Sidoqoftë, meqë ky version i letrës do të jetë përfundimtar, ja dhe një plotësim për dhembjen shkallmuese, goditjen e madhe që një ditë sërish na bëri bashkë. Atëherë, kur u preka thellë për Jorge

Federiko-n tuaj, kurrsesi s'më shkonte nëpër mend se fati, ky zarf që kyç sekretin hyjnor, një ditë do të më sillte të njëjtën gjëmë për tim bir, Dritanin 36-vjeçar. Vdekja është ajo që e dimë, por që nuk e kemi provuar dhe kur ta provojmë, prapë nuk do ta njohim. Çdokujt i mbetet vetëm një mundësi: ta njohë duke parë si largohen të tjerët. Prandaj, kur keni lotuar atëherë për djalin tuaj, e besoj pa mëdyshje, në mendje keni pasur edhe djemtë e tjetërkujt. Se ky është shpirti juaj, të tillë librat tuaja, i tillë universalizmi i babushit Ernesto Sabato. Zemrat bujare nuk e qarkullojnë Të Mirën nëpër botë që t'u kthehet, por që vetë njerëzimi të bëhet më i mirë.

Poshtëshënim: Mjeshtë, ju e dini fort mirë se, ashtu si lavdia, breroja nuk është veçse shkëlqimi i jashtëm i kometës. Në të vërtetë, kometat udhëtojnë duke djegur vetveten. Ju tashmë keni vajtur edhe sipër tyre, në Qiellin e shtatë. Megjithëse deri në ditën time do të komunikojmë në distancë, ju lutem, tregoni kujdes që derën ta lini hapur. Kur të jemi së bashku, këtë letër nuk do ta kem me vete. E përse u dashkan letrat, fletoret, librat e botuar dhe dorëshkrimet e tyre?! Të gjitha këtej mbesin. Ne do të flasim ahëre sy më sy, pa daulle, pa ceremonira, pa çmime e medalje, pa ndërmjetës. Dhe, sigurisht, pa shkarje të kujtesës, por me atë kthjellimin e epërm që ta jep vetëm një gjuhë, ajo shpirtërorja, kur Të Vërtetat rrefehen para Zotit./Exlibris.al

Gazeta "Drita", 28 qershor 1992

Kthim në kohë: Prejardhje shqiptare

- Teksti i plotë, ku shkrimtari i madh Ernesto Sabato
pohon origjinën e tij -

Zija Çela

Kur më 1945, pas një krize komplekse shpirtërore, Ernesto Sabato, i cili lindi më 24 qershor 1911, i dha lamtumirën përgjithmonë shkencës për t'u marrë me letërsi, mjaft personalitete të njohura u shprehën me keqardhje, duke qenë të sigurtë se ai do të kishte mundur t'i viente njerëzimit më tepër si shkencëtar sesa si shkrimtar. Dhe ata e kishin një bazë, sepse po ndabej me shkencën një ish-nënësi i çifitit botëror Irenë e Zholio Kyri, një njeri që kishte shkëlqyer me studimet në fushën e fizikës e matematikës e që, madje, nuk ishte nguruar as për ta quajtur gjeni. Por do të kalonte vetëm pak vjet dhe do të dëshmohej drejtësia e kësaj lamtumire: argjentinas Ernesto Sabato do të shkëlqejë si shkrimtar, duke u bërë një nga penat më të fuqishme të kontinentit latino-amerikan e zërat shprehës të shekullit. Në mënyrë të veçantë, atë do ta bënte të njohur trilogjia e tij romaneske. "Tuneli" që u botua më 1948 (Graham Grini do ta përkthente në anglisht dhe Kamy në frëngjisht); "Mbi heronjtë dhe varrezat" (1961); si dhe "Abandoni; ëngjëll i shkatërrimit" (1974). Pikërisht në këtë roman voluminoz dhe aq origjinal; kur autori tashmë i kishte ka-

gjënë, në rrugën ripërsëritëse drejt femijërisë, Ernesto Sabato do të shprehë gjatë për prejardhjen e tij shqiptare. Ai do ta ngrinte në një shkallë të përgjithësuar vëzhgimin e Apollinerit duke pranuar si njërin nga tiparet karakteristike të racës shqiptare «vitalitetin mbinjerëzor dhe një prirje vetëvrastëse». A ka ndikuar kjo trashëgimi gjenetike tek Sabato atëherë kur mori «vendimin kërkues» për t'u divorcuar me racionale (shkencën) dhe për tu dhënë pas emocionale (artit)? Në libër do të ndjehet tërthorazi kjo përgjigje. Sipas meje vitaliteti mbinjerëzor dhe prirja vetëvrastëse më drejtë – vetëgjësuese, duhet interpretuar si filozofi popullore e shqiptarit për ta përballuar e për ta gëzuar jetën kudo të ndodhet dhe për të mos i shkuar varrit pa e konsumuar veten deri në fund për së gjalli, si një qënie shoqërore e biologjike.

Pohimi i Sabatos për prejardhjen e tij është përmendur dhe herë tjetër në "Drita", kohët e fundit edhe në një prezantim të gjerë që i bëhet këtij shkrimtari në gazetën «E PËRTHYEME». Por asnjëherë nuk është botuar tek ne vetë teksti autentik i autorit që po e japim të plotë më poshtë. Vëç të tjerave, ndoshta kjo ka ardhur edhe nga ndrojtja për t'u ballafaquar me mënyrën diatë vrazhdëse si jepet ajo ndonjë pasaktësi. Por duhet pasur parasysh se gjithëcka është vendosur në kontaktin e përgjithshëm të një vepra letërore dhe se njohuritë e të huajve për shkrimtarët as nuk kanë qenë e as nuk ishin gjithnjë të përkryera.

Fragmenti është përkthyer nga «ëngjëlli i errësirës», botim frëngjisht; faqe 265-268.

luar të gjashtëdhjetat dhe rruga drejt përqishtë ishte gati si një kthim në ori-

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Drita rimerr pozitën e parë, Gjilani shënon fitore bindëse

Nga gjashtë ndeshjet e zhvilluara në Superligë, pesë prej tyre i kanë realizuar skuadrat mysafire. Drita, pas fitores kundër Trepçës '89, e ka rikthyer pozitën e parë, kurse fitores të dielën i është gëzuar edhe Gjilani në përballje me Vushtrrinë. Të shtunën Drenica befasoi Llapin, kurse Prishtina nuk gaboi ndaj Vushtrrisë



EPOKA E RE
Veton ZYMBERI
PRISHTINË, 14 QERSHOR - IPKO Superliga e Kosovës në futboll vazhdon të bëhet gjithnjë e më interesante, kurse skuadra e Dritës e ka rimarrë pozitën e parë, pasi e të dielën në stadiumin "Riza Lushta" e mposhti Trepçën '89 me rezultat 0-2. Golin e parë në ndeshje e shënoi Xhevdet Shabani në minutën e 16. Me këtë rezultat përfundoi pjesa e parë e ndeshjes, kurse golin e dytë dhe të fundit në ndeshje e shënoi Kastriot Rexha. Në dhjetë minutat e fundit të ndeshjes, 89-shi luajti me një lojtar me pak, pasi me karton të kuq u ndëshkua Richard Asare. Pas kësaj fitore, Drita ka grumbulluar 49 pikë, kurse Trepça '89 mbetet në pozitën e nëntë me 27 pikë. Skuadra e Gjilanit u është rikthyer fitoreve në Superligë. Kjo skuadër e mposhti Ferizajn me rezultat bindës 0-3 dhe në këtë mënyrë është inkuadruar seriozisht në garën për titull në elitë.

Golat për skuadrën e Gentian Mezanit në pjesën e parë i shënuan Gerhard Progni dhe Darko Nikaq, kurse në fillim të pjesës së dytë ka shënuar edhe Fiton Hajdari për epërsinë 0-3. Pas kësaj ndeshje Gjilani është në pozitën e katërt me 45 pikë, derisa mbetet në pozitën e dhjetë me 25 pikë. Fitores të shtunën i është gëzuar edhe Prishtina, e cila po tregon formë të lartë pas rikthimit të futbollit pas pushimit për shkak të pandemisë. FC Prishtina në kuadër të javës së 24-t në Superligë ka shënuar fitore të lehtë në duel me Vushtrrinë, në stadiumin "Ferki Aliu", me rezultat 2-0. Të dy golat e fitores për skuadrën kryeqytetase i shënoi sulmuesi Oto John, në minutat 11-të dhe 36. Ndërkohë, Drenica e ka shkaktuar befasinë më të madhe në këtë xhiro, pasi e ka mposhtur Llapin në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" me rezultat 0-2. Sulmuesi Alban Shillova ishte realizues i dyfishtë për skuadrën kuqezi nga Skenderaj.

IPKO Superliga

Trepça '89 - Drita	0-2	
Ferizaj - Gjilani	0-3	
Vushtrria - Prishtina	0-2	
Llapi - Drenica	0-2	
Dukagjini - Feronikeli	0-2	
Flamurtari - Ballkani	0-0	
Tabela		
1. Drita	24	49 pikë
2. Prishtina	24	47
3. Ballkani	24	46
4. Gjilani	24	45
5. Feronikeli	24	40
6. Llapi	24	37
7. Drenica	24	34
8. Flamurtari	24	29
9. Trepça '89	24	27
10. Ferizaj	24	25
11. Vushtrria	24	16
12. Dukagjini	24	10

Në xhiron e radhës takohen: Drenica-Flamurtari, Ballkani-Trepça '89, Drita-Ferizaj, Gjilani-Vushtrria, Prishtina-Dukagjini, Feronikeli-Llapi.

SHKURT

Januzaj: Pogba nuk do të largohet nga Unitedi

Futbollisti me origjinë shqiptare Adnan Januzaj beson se Paul Pogba do t'i refuzojë ofertat e Real Madridit dhe Juventusit dhe do të qëndrojë në "Old Trafford". Januzaj dhe Pogba kanë qenë bashkë te Manchester Unitedi që nga academia. "Unë besoj se Pogba do të qëndrojë. Jam ende shumë i afërt me Pogban. Ne jemi njohur që fëmijë dhe kemi luajtur bashkë tek academia e Manchester Unitedit", ka thënë Januzaj. Kampioni i botës me Francën ka qenë i lidhur me Real Madridin dhe Juventusin mbi një transferim të mundshëm.

Trajneri i Bremenit: Ne kemi nevojë për cilësitë e Rashicës

Sulmuesi i Kosovës, Milot Rashica, dështoi të shënojë gol nga penalltia në ndeshjen kundër Paderbornit, kurse trajneri i Werder Bremenit, Florian Kohfeldt, ka thënë se do të flasë me Rashicën. Sipas Kohfeldt, Bremenit ka nevojë të madhe për cilësitë e futbollistit nga Vushtrria. "Miloti u mundua dhe bëri disa aksione të mira, por nuk ishte në ditët e tij më të mira në aspektin ofensiv. Nuk do të ketë asnjë masë ndaj tij sepse fituam. Do të flas me të sepse ne kemi nevojë për të në formë të mirë. Penalltia e humbur nuk do ta penalizojë", ka thënë Kohfeldt.

De Biasi: Më ka kushtuar shumë largimi nga Shqipëria

Gianni de Biasi e vlerëson periudhën gjashtëvjeçare të drejtimit të Kombëtares së Shqipërisë si kohën më të bukur sportive të jetës së vet. Trajneri italian kujtoi momentin kur dha dorëheqje nga posti i trajnerit të Shqipërisë tri vjet më parë përpara se të mbyllte fazën eliminatore të Kupës së Botës 2018. "Tri vjet më parë vendosa të largohesha nga kombëtarja e Shqipërisë, një moment i vështirë për mua!!! Synimi ishte të lejoja ata që do të më zëvendësonin mua të kishin kohë të mjaftueshme për t'ju njohur lojtarët. Më ka kushtuar shumë por, si çdo gjë në jetë, ka gjithmonë një fillim dhe një fund, një histori e bukur duhet të ketë një fund. Faleminderit Shqipëri, faleminderit president Duka, faleminderit të gjithë djemve protagonistë që mundësuan rrugën drejt ëndrrës sonë. Faleminderit që më lejuat t'i përjetoj emocionet më të bukura sportive të jetës sime!", ka shkruar De Biasi.

Themelohet Klubi i Shahut "Ali Haskaj"

DEÇAN, 14 QERSHOR - Në kuadër të ditëve të çlirimit të Kosovës, me iniciativë të bashkëluftëtarëve të UÇK-së dhe disa vullnetarëve nga fshati Irzniq i Komunës së Deçanit, të

shtunën është themeluar Klubi i Shahut "Ali Haskaj". Ali Sadik Haskaj (1962-2010) ishte ndër luftëtarët më të dalluar në angazhimin e tij për çlirimin e tokave shqiptare në

Kosovë, Maqedoni dhe Preshevë, raporton "Epoka e re". Ali Haskaj ishte plagosur disa herë në luftimet me forcat pushtuese serbe, por ai ndërroi jetë në vitin 2010. Klubi i

Shahut "Ali Haskaj" ka zgjedhur edhe Bordin Drejtues dhe kryetar. Kryetar i Klubit të Shahut "Ali Haskaj" është zgjedhur invalidi i UÇK-së, Avdyll Çeku.



Klubi i Gjmnastikës 'Fushë-Kosova' fillon stërvitjet në sallën e re

FUSHË KOSOVË, 14 QERSHOR - Klubi i Gjmnastikës "Fushë-Kosova" ka filluar stërvitjet pas pauzës së gjatë për shkak të pandemisë Covid-19. Ky klub stërvitet i ka filluar në sallën e re që është ndërtuar

nga komuna e Fushë-Kosovës, kurse trajnerja Sherife Aliçkaj-Qerimi e ka falënderuar komunën për përkrahjen që po ua jep klubeve sportive. "Komuna e Fushë-Kosovës njihet si një vend që e

përkrahë sportin në masë të madhe. Këtë e vërtetoi edhe me ndërtimin e sallës së re, në të cilën do t'i kryejnë stërvitjet klubet e shumta, kurse një prej tyre është Klubi i Gjmnastikës 'Fushë-Kosova',

të cilit, me ndihmën e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në krye me drejtoreshën Nurie Avdiu, iu dha mundësia që t'i fillojë stërvitjet po në këtë sallë", ka thënë Aliçkaj-Qerimi.



Fitore bindëse nga Besa dhe Trepça



Pejë, 14 qershor - Kampioni Besa Famgas ka bërë hapin e parë drejt finales së "play-off"-it në Superligën e Kosovës në hendboll pasi në palestrën "Karagaçi" në Pejë e ka mposhtur Kastriotin me rezultat 41:28. Ishte kjo gjysmëfinalja e parë e "play-off"-it. Para ndeshjes është bërë kontrollimi shëndetësor i lojtarëve si pjesë e masave të task-forcës ndaj Covid-19. Ekipi pejan ka dominuar në ndeshje dhe vazhdimisht ka pasur epërsi bindëse.

Kastriot Jupa ishte më efikas te Besa me 9 gola, derisa te Kastrioti u dallua Bislimi me 8 gola. Ndeshja e dytë luhet në mesjavën e ardhshme në Ferizaj. Në ndeshjen tjetër Trepça ka shënuar fitore në kryeqytet ndaj Prishtinës.

Mitrovicasit kanë mposhtur skuadrën kryeqytetase me rezultatin e lartë, 31:23. Ishte kjo ndeshja e parë gjysmëfinale e "play-off"-it në Superligën e Kosovës në hendboll. Para ndeshjes është bërë kontrollimi mjekësor i lojtarëve si pjesë e masave ndaj Covid-19. Ndeshja është dominuar plotësisht nga Trepça që ka bërë hap të madh drejt finales. Ndeshja e kthimit luhet në mesjavë në Mitrovicë, pa shikues, ashtu si ndeshja e parë. Trepça ishte vazhdimisht në epërsi. "Xehetarët" ishin më të angazhuar në mbrojtje, ndërsa në sulm të pandalshëm ishin Maxhera e Klinaku që realizuan nga nëntë gola. Por me angazhim janë shquar të gjithë. Te Prishtina më efikasit ishin Beshiri e Bajqinovci me nga 4 gola.

Istogu e Vushtrria drejt finales

Istogu dhe Vushtrria kanë fituar ndeshjet e para gjysmëfinale të "play-off"-it në Superligën e hendbollisteve. Istogu në kryeqytet fitoi ndaj Prishtinës me rezultat bindës 43:12. Prishtina është paraqitur me lojtare të reja.

Shumë më tepër rivalitet kishte në Ferizaj ku u takuan Ferizaj e Vushtrria. Fitore shënoi Vushtrria me rezultat 27:24. Pas pjesës së parë Ferizaj ishte në epërsi prej një goli. Rama me 13 gola udhëhoqi Vushtrrinë. Te Ferizaj u dalluan Fazlija e Koneski me nga 7 gola. Ndeshjet e dyta luhet mesjavën e ardhshme. Ndeshjet janë luajtur pa shikues dhe pas kontrollimit mjekësor të lojtarëve.

Futbollisti i Norwichit del pozitiv në testin për Covid-19

Një lojtar i Norwich Cityt është një nga dy personat që kanë dalë pozitivë në testimet për koronavirusin pas raundit të fundit prej 1.200 testeve të kryer para rifillimit të Premierë Ligës. Testet u zhvilluan të enjten dhe të premten, ndërkohë që Norwichi u mund nga Tottenhami 2-1 në një miqësore të luajtur të premten. Skuadra e Mourinhos konfirmoi se nuk kishte asnjë lojtar pozitiv, ndërkohë që

futbollisti i Norwichit nuk ka pasur "kontakte të ngushta" me ekipin e tij. Lojtari, emri i të cilit nuk është zbuluar, do të izolohet për shtatë ditë. Premierë Liga do të rifillojë më 17 qershor, e Norwichi, i fundit në renditje, do ta bëjë debutimin kundër Southamptonit të premten e 19 qershorit. Në total ka pasur 16 raste pozitive nga 8 687 testet e kryera në Premierë Ligë.

SHKURT

Messi vendos edhe një rekord në La Liga

Ylli i Barcelonës, Lionel Messi, ka regjistruar një rekord të ri në La Liga, pas fitores së Barçës kundër Mallorcës. Argjentinasi u përfshi direkt në tri gola, duke dhënë dy asistime për shokët e skuadrës, si dhe duke shtuar një gol. Kështu, Messi është bërë lojtari i parë që të shënojë 20+ gola në 12 sezona radhazi në La Liga. Me dy asistimet e fundit, Messi shkon në 14 asistime në total në këtë kampanjë të La Ligës, duke u bërë tashmë golashënuesi më i mirë, por edhe asistuesi më i mirë në La Liga.

Leonardo konfirmon largimin e Cavanit dhe Silvës nga PSG-ja

Ashtu siç ishte folur gjatë këtyre ditëve në media, ka ardhur më në fund edhe konfirmimi zyrtar nga drejtuesi i Paris Saint Germainit, Leonardo, që në një intervistë për mediat franceze pranoi se Edison Cavani dhe Thiago Silva do ta lënë kryeqytetin francez në fund të sezonit. "Kemi mbërritur në fund, pasi klubi nuk u ka ofruar kontratë të re Cavanit dhe Silvës, kështu që ata sezonin e ardhshëm nuk do të jenë pjesë e jona. Ideja jonë për momentin është që të firmosim një kontratë dy mujore për t'i pasur deri në fund të gushtit, duke qenë se do të luhen ndeshjet e mbetura të Ligës së Kampionëve", ka deklaruar Leonardo.

Ibra largohet nga Milani, rikthehet në Suedi


Zlatan Ibrahimoviç do të largohet nga Milani në fund të këtij sezoni dhe do të rikthehet në Suedi te klubi i tij, Hammarby, sipas mediave italiane. Thuhet se sulmuesi suedez e kishte shfaqur zemërimin e skuadrës gjatë një takimi me shefin ekzekutiv të Milanit, Ivan Gazidis, duke e kritikuar atë për mënyrën se si po e udhëheq klubin. Si pasojë, mundësitë që ai ta zgjatë kontratën përtej këtij sezoni janë shumë të pakta. "Gazetta dello Sport" shkruan se lidhja e 38-vjeçarit me Milanin nuk është më siç ishte deri para se ai të rikthehej në klub në janar. Sipas së përditshmes italiane, ai do t'i bashkohet Hammarby, klubin në të cilin ka aksione dhe me të cilin stërviti gjatë karantinës së koronavirusit. Deri atëherë ai do të përpiqet t'i ndihmojë Milanit të kualifikohet në Ligën e Evropës.
































Reali ofron 80 milionë euro për Kanten


N'Golo Kante mund të largohet nga Chelsea për arsye financiare dhe Real Madridi është gati ta presë me krahëhapur. Mesfushori punëtor i përfaqësueses së Francës do të shkonte me dëshirë në kryeqendrën spanjolle për shkak se atje do ta gjente trajnerin Zinedine Zidane. Sipas lajmit që publikon "AS", "Los Blancos" janë të gatshëm të vënë në tavolinë 80 milionë euro për kartonin e mesfushorit dhe për ta sjellë atë në Spanjë. Londinezët e patën blerë Kanten nga skuadra e Leicester Cityt katër sezona më parë për rreth 40 milionë euro.

Unitedi mendon ta rikthejë Sanchezin

Manchester Unitedi kërkon ta rikthejë Alexis Sanchezin në "Old Trafford" pavarësisht se i kushton 550 mijë euro në javë dhe nuk shihet si titullar. Sipas së përditshmes spanjolle "AS", Unitedi është i bindur në këtë pikë, mbetet vetëm për t'u përcaktuar se kur do të rikthehet, më 30 qershor, kur i mbaron huazimi, apo në fund të sezonit të Interit, që mund të shkojë deri në fund të gushtit nëse zikaltrit ecin më tej në Ligën e Evropës.



 Autor: GAZMEND MORINA						AKTORI I FAMSHËM NË FOTO (shqip.)	DOKUMENTI QË PËRMBAN KËRKESËN PËR TË RISH-QYRTUAR NJË VENDIM GJYQI (jurid.)	MI I VOGËL	FILM I YNI "... ISHIN KATËR"	BANORET E NJË SHTETI SKANDINAV	DY ZANORE	SHTET NË AMERIKËN VERIORE	EPOKA ERE	AXHAMI, I ...	SHTRESË E SIPËRME AJRI	ISH ATLETI AMERIKAN MONTGOMERI		
 VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU SI JELEK ME GAJTAN															AKTORI I FAMSHËM ... DAMON (shqip.)			
 MBISHKRIMI NË NJË GUR VARRI															INTENSITET, TITAN BANOR I NJË SHTETI AZIATIK			
 AKTORI TURK IMIRZALIOGLU											MË VJEN GJUMË DUKE NDENJUR ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER							
 INTERNATIONAL LEADERSHIP UNIVERSITY									PASANIKE							TRUP GJEOMETRIK		
 PREK LEHTË									DËM, SHERR QYTET I MADH NË SUEDI						BASHKËT, LLOJ BIME QË PËRDORËT GJERËSISHT SI USHQIM (sh.shq.)			
 ERMELINDA MEKSI								MUZIKANTI ... KISERI PËRA QË MERRËN PËR NJË KOHË TË CAKTUAR NGA DIKUSH						FJALË POHUESE GJYNAH				
 ISH FUTBOLLISTI I NJOHUR TURK KAHVECI (VIL-LARREAL)											SYSHTRËMBËR MAJE KOCKE QË DEL NË KOKËN E NJË KAFSHE							
 NDARJE NË KLASA, RENDITJE						LIRIDASHËSI	I PARI I XHAMISË (pashq.)	SHENJË QË PËRFAQËSON NJË TINGULL MUZIKOR (sh.shq.)	ALESANDRO NESTA	 PËRSHTATJA E NJË SENDI NJË SENDI TJETËR						UTAH, LOUISIANA QËLLOVA RASTËSISHT NË NJË NGJARJE	PJESË E MISHTË QË MBULON DHËMBËT (sh.shq.) TOPI JASHTË LOJE	POPULL (turq.)
 QYTET NË KOSOVË																RREMUJË ALFRED KAÇINARI	ZOTËROJ DIÇKA SHUHET	
 PJË FRESKUESE E ATHËT										ORGANIC USER INTERFACES BASHKËT.			NJËSIA E MATJES SË FUQISË SË RRYMËS VONIM (sh.shq.)					
 KRYEMURG									QËLLIM I PARAMENDUAR NEON, KALIUM				BASHKËT, LLOJ VEGLË MUZIKORE	NGASËSI I "FORMULA 1" SEBASTIAN SHOK				
 LUMË NË SHQIPËRI									DY BASHKËTINGËLLORE SHTET NË AZI "... LANKA"		LLOJ AGRUME BASHKËT.			"TETOVA" FUTBOLLISTI KALOU (CHELSEA)				
 "IRLANDA"							TË TESTUARIT SHARRËZ (shq.)					REGJISORJA ... GJONI PËREMËR VETOR			BASHKËT, PJESË E AUTOMJETIT PËR TË MBAJTUR DREJTJEMIN			
 MBARËSI GATESE E JONA (sh.shq.)							REPERI AMERIKAN BROWN (shqip.) DISIPLINË SPORTIVE		FLUTURAKE E SHPEJTË USHTARAKE (sh.shq.) SIPËR						FEMRA E ZGJEDHUR NË NJË KONKURS BUKURIE			
 →							TERRITORI IMAMIT LETRARI MARTIN					EMËR YNI MASHKULLI ANIJATA						
 QYMEZ							ZANORE VËLLIMI, MASA	BRAGA NGJYRË E FYTYRËS		DEGË MJEKËSISË DY BASHKËTINGËLLORE								
 BANORI I IRANIT, IRANIAN							LLOJ, SOJ KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)			ALBERTO TOMBA I DHASHË FALAS			SUPER MODELJA KATE ... KRITER					
 E CAKUT MË TË POSHTËM									AKTORJA E NJOHUR ... TYLER BOSHTI			KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE ANALISTI POLITIK BLERIM ...						
 BUNAR						KLUB FUTBOLLI SPANJOLL JO I VJETËR								DEM, KA	ISH ATLETA MERLIN			
 I PISTË							JACKSONVILLE INTERNATIONAL AIRPORT ADEM JASHARI		GRYKË E VULLKANIT NGA KU DEL LAVA ABEDIN REXHA					TEFIK OSMANI MIMOZA OSAJ				
 NEVOJA E THEKSUAR QË KEMI PËR TË NGRËNË							VENDËS VOLTI			LAKESAT BASHKËT.								
 SILIC							JANI VRETO		PJESË E SYRIT			PERËNDESHA E DASHURISË NË MITOLOGJINË ROMAKE						



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► N.S.H.P. "Eng-Co" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 80253486.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m², e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m², kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m². Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m², dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULË

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues